SIGURIA KIBERNETIKE DHE PËRGJIGJET SHUMËAKTORIALE NDAJ KËRCËNIMEVE DHE TERRORIZMIT KIBERNETIK

Përmbledhje praktikash dhe legjislacioni

2024

Instituti për Aktivizëm
dhe Ndryshim Social

Ky studim është produkt i programit "Siguria kibernetike një kërcënim modern për demokracinë", zbatuar nga Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social, mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përmes Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci

Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social
Rruga Sulejman Delvina, p2/3, apt.1, Tiranë www.ians-albania.org

Tabela e lëndës

1. Hyrje

Studime dhe analiza e kërcënimeve dhe sulmeve kibernetike tregon se autorë që mund të prodhojnë të tilla ngjarje të rënda me impakt të gjerë publik janë shtete, grupe të krimit të organizuar dhe aktorë të tjerë joshtetërore (terroristët). Përmes Rezolutës nr.2341 (2017), Këshilli i Sigurimit i OKB-së thekson domosdoshmërinë për përgatitje dhe përgjigje ndaj varësisë kibernetike të shoqërive, e cila shfrytëzohet gjerësisht nga grupet terroriste. Këshilli i Sigurimit u bën thirrje shteteve anëtare të investojnë për mbledhjen dhe ruajtjen e provave digjitale ndaj përgjegjësve të sulmeve terroriste dhe mënyrës së përdorur për shfrytëzimin e teknologjisë së komunikimit të informacionit (TIK) nga ana e terroristëve[1]. Këshilli thekson se si mbrojtja e infrastrukturës kritike kundër sulmeve terroriste kërkon përpjekje shumëplanëshe që lidhet me sigurinë mbrojtëse të shteteve, përfshirë këtu dhe sigurinë kibernetike[2]. OKB, nga ana tjetër, ngre alarmin se, "grupet terroriste po fitojnë kapacitete për të nisur sulme terroriste përmes internetit, për dëmtimin e infrastrukturës kritike, sistemeve të kontrollit industrial ose pajisjet IoT (Internet of Things)[3].

> "Grupet terroriste kanë fuqizuar kapacitetin e tyre për sulme terroriste përmes internetit, e për pasojë, dëmet në infrastrukturën kritike, sistemet e kontrollit industrial ose pajisjet dhe Internet of Things (IoT) janë të ndjeshme dhe shpesh të pariparueshme".
>
> *Fleta informuese "Për teknologjitë e informacionit dhe komunikimit", OKB*

Krahas sulmeve kibernetike, një kërcënim faktik përfaqëson edhe terrorizmi kibernetik ose terrorizmi nëpërmjet përdorimit te internetit. Ai paraqitet sporadik për shkak të aftësive teknike specifike për të ndërmarrë një sulm të tillë. Komuniteti ndërkombëtar i njeh dhe u jep përparësi këtyre çështjeve përmes programit global kundër terrorizmit lidhur me sigurinë kibernetike dhe teknologjitë e reja, i cili zbatohet nga Zyra e OKB-së kundër Terrorizmit. Ky program shërben si një instrument për të mbështetur shtetet anëtare në forcimin e kapaciteteve të tyre për të zhvilluar dhe zbatuar një përgjigje efektive ndaj këtij kërcënimi dinamik[4]. Morisë së institucioneve dhe mekanizmave raportues për masat parandaluese i shtohet edhe Zyra e OKB-së për Çështjet e e cila bashkërendon zhvillimet në fushën e informacionit dhe telekomunikacionit, në kontekstin e sigurisë globale Çarmatimit, përmes takimeve në nivel ekspertësh qeveritarë.[5]

---

[1] United Nations Security Council Counter Terrorism Committee Executive Directorate (CTED) (Unknown). 'Information and Communications Technologies Factsheet'. (Accessed online).
[2] United Nations (2017). Security Council Resolution 2341, p. 2. (Accessed online).
[3] United Nations Security Council Counter Terrorism Committee Executive Directorate (CTED) (Unknown). 'Information and Communications Technologies Factsheet'. (Accessed online).
[4] NOCT (Unknown). 'Cybersecurity'. (Accessed online).
5 United Nations (no date). 'Developments in the Field of Information and Telecommunications in the Context of International Security', UN Office of Disarmament Affairs. (Accessed online).

Pavarësisht njohurive dhe informacionit të deritanishëm mbi kërcënimet, rrezikun për sulme apo vetë sulmet kibernetike (terroriste ose jo); masat e ndërmarra nga shtetet (e përmes politikave dhe kuadrit rregullator të caktuar) si dhe nga strukturat e sigurisë kombëtare nuk kanë garantuar në praktikë gatishmërinë e të gjithë aktorëve që preken nga këto kërcënime dhe rreziqe për sulme. Këtu bëhet fjalë për qytetet në funksionimin e të cilave gjenden objekte të infrasktrukturës kritike, shërbime jetike për popullatën si p.sh., shërbimet shëndetësore, ujësjellësat, transporti, bankat apo bizneset lokale[6]. Në këtë raport infrastruktura kritike në komunitet, në qytet apo rajon vlerësohet si pjesë e rëndësishme e funksionimit të komunitetit, qytetit dhe qytetarëve apo rajonit të caktuar; krahas përcaktimit si komponent thelbësor i sigurisë kombëtare. Për këtë arsye, qasja analitike orientohet drejt përgatitjes qytetare dhe institucionale, ndërgjegjësimit dhe diskutimit për përmirësime ligjore në lidhje me rreziqet e mundshme të terrorizmit kibernetik.

Gjithashtu, këtu bëhet fjalë për nevojën për informim dhe ndërgjegjesim të vazhdueshëm qytetar, për rrezikun e mundshëm ndaj sulmeve kibernetike dhe përgatitjen e paneve vendore të përgjigjeve, në reduktimin e impaktit të këtyre sulmeve tek qytetari si përdorues fundor i gjithë të mirave, shërbimeve dhe objekteve që konsiderohen si infrastrukturë kritike. Në këtë mënyrë, ky raport synon të angazhojë autoritetet (qendrore dhe vendore) në përmirësimin e masave parandaluese ndaj një sërë kërcënimesh kibernetike, përmes prezantimit të disa praktikave ndërkombëtare në mënyrën e menaxhimit operacional të sulmeve kibernetike dhe sulmeve kibernetike terroriste; si dhe, për përpjekjet në reduktimin e rreziqeve për sulme të tilla.

Nevoja për të rritur gatishmërinë ndaj sulmeve kibernetike, sidomos ndaj atyre sulmeve me impakt të gjerë në botën reale, është mesazhi kryesor i këtij raporti. Një strategji e qëndrueshme dhe sistematike që synon mbrojtjen dhe garantimin e funksionimit të sistemeve kibernetike dhe që i adresohet qyteteve/bashkive që administrojnë pjesë kryesore të infrasktukturës kritike; si dhe, përfshirja dhe përgatitja qytetare për të rritur gatishmërinë në kundërpërgjigje, është thelbësore

[6] Hill, S., Creese, S. (2021). 'Why Cyber Resilience Must be a Top-Level Leadership Strategy', CAPCO Institute Journal 53: operational resilience (May), p. 82. (Accessed online).

në kushtet aktuale për autoritetet shtetërore. Me rëndësi për këtë gatishmëri duhet të paraqitet, gjithashtu, ekuilibri delikat ndërjet shfrytëzimit të përfitimeve të hapësirës kibernetike dhe teknologjisë vis-a-vis garantimit të sigurisë dhe gatishmërisë në rast sulmesh. Kjo nevojë ndërlidhje së sigurisë kibernetike me sigurinë fizike konsoderohet evolucioni i së ardhmes së përbashkët[7] të njerëzimit.

Fokusi parësor

Hapësira kibernetike dhe gjithnjë e më shumë AI, janë bërë themeli i teknologjive të përditshme. Hapësira kibernetike mund të përkufizohet si një "mjedis kompleks që rezulton nga ndërveprimi i njerëzve, softwerëve dhe shërbimeve në internet me anë të pajisjeve teknologjike dhe rrjeteve të lidhura me të, që nuk ekziston në asnjë formë fizike[8]. Kjo hapësirë fluide, e paprekshme, bëhet gjithnjë e më sfiduese kur përdoruesit, pajisjet, sistemet dhe proceset, gjithnjë e më shumë, lidhen dhe ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Ndaj, përdorimi i hapësirës kibernetike, inteligjencës artificiale (AI) dhe teknologjitë e avancuara mund të dëmtojnë shoqëritë nëse përdoren për qëllime keqdashëse nga aktorë armiqësorë. Strategjia e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për teknologjitë e reja pranon rreziqet e mëdha që sjellin këto teknologji. Strategjia thekson se "ndërsa hapësira kibernetike ka hyrë pothuaj në çdo aspekt të përditshmërisë, shkalla dhe përhapja e 'pasigurisë kibernetike' njihet gjithashtu si një shqetësim serioz.

Raporti i Komisionit Evropian "The Landscape of Hybrid Threats: A Conceptual Model" eksploron fusha të ndryshme të kërcënimeve hibride, duke përfshirë dhe kërcënimet kibernetike. Në këtë raport theksohet gjithashtu se "çdo gjë me rëndësi në botën reale ndodh njëlloj edhe në hapësirën kibernetike; dhe për pasojë, dimensioni kibernetik luan një rol të jashtëzakonshëm". Raporti është i qartë në deklaratën e tij se "Hapësira kibernetike ofron një mekanizëm të ri shpërndarjeje që mund të rrisë shpejtësinë, përhapjen dhe fuqinë e një sulmi dhe të sigurojë anonimitetin dhe pazbulueshmërinë. Vlera e ulët në përdorim, anonimiteti dhe asimetria në cënueshmëri do të thotë se aktorët më të vegjël kanë më shumë kapacitet për të ushtruar pushtet në hapësirën kibernetike krahasuar me fusha më tradicionale të politikës botërore" [9]
Në një botë ku krimi kibernetik i nivelit të ulët po kthehet në një realitet të ri rrezikshmërie, kushdo që ka akses në sistemet kompjuterike ose pajisjet celulare do të jetë i vetëdijshëm për mashtrimet me anë të "phishing", sulmet me "malware" (në veçanti të tipit "ransomware") që bombardojnë përdoruesit çdo ditë. Kjo pikëpamje, që mbështetet gjerësisht nga Interpol[10], thekson mënyrën sesi krimi kibernetik përparon me një ritëm shumë të shpejtë, me rrjete komplekse kriminale, që veprojnë në mbarë botën dhe që koordinojnë sulme komplekse që mund të ekzekutohen në pak minuta[11]
Siç paralajmëron Shërbimi Kombëtar i Sigurisë në Mbretërinë e Bashkuar, këto kërcënime më pak të dukshme kanë potencialin të na prekin të gjithëve, duke përfshirë shërbimet publike – madje duke sjellë

[7] Barnard, P. (2020). 'Martyn's Law in a Security Convergent World', IFSEC Global. (Accessed online).
[8] ISO (2012). 'ISO/IEC 27032:2012: Information Technology – Security Techniques – Guidelines for Cybersecurity'. (Accessed online).
[9] Giannopoulos, G., Smith, H., Theocharidou, M. (2020). 'The Landscape of Hybrid Threats: A conceptual model', European Commission, Ispra, p. 28 (Accessed online).
[10] ISO (2012). 'ISO/IEC 27032:2012: Information Technology – Security Techniques – Guidelines for Cybersecurity'. (Accessed online).
[11] Interpol (no date). 'Cybercrime'. (Accessed online).

impakt të drejtpërdrejtë në jetën dhe dinjitetin njerëzor[12].
Krahas këtij indikatori specifik, shtetet midis tyre apo në përballjen e tyre me grupet kriminale jo-shtetërore dhe individët, mund të zhvillojnë qasje destabilizuese për shkak të qëndrimeve akuzuese në përcaktimin e përgjegjësisë për sulmet kibernetike.[13]
Sulmet kibernetike mund të përdoren si taktikë nga çdo aktor armiqësor. Edhe pse shtetet njihen për nivele më të larta të aftësive sulmuese kibernetike, mendohet se aktorët joshtetërorë kryejnë shumicën e sulmeve kibernetike, qoftë për veten e tyre apo për një shtet që nuk dëshiron të zbulojë sponsorizimin e sulmit. [14]
Përmes rasteve studimore ndërkombëtare, të identifikuara për kontektin e këtij raporti, synohet shpjegimi i mënyrave jokonvencionale të sulmeve kibernetike, të cilat po shndërrohen në instrumente të një lufte hibride ndërmjet paqes dhe konfliktit; dhe, po përdoren njëlloj si nga aktorë shtetërorë ashtu dhe nga aktorë jo-shtetërorë apo individë.

Financimi i sulmeve terroriste përmes internetit, sillet në këtë raport, si një kërcënim ndaj hapësirës kibernetike dhe nevojë për rregullim ligjor specifik në Shqipërinë.

[12] McCallum, K. (2021). 'Director General Annual Threat Update', UK Security Service MI5. (Accessed online).
[13] United Nations (2018). UN Secretary General's Strategy on New Technologies, pp. 8-9. (Accessed online).
[14] Kreps, S. (2021). 'Democratizing Harm: Artificial Intelligence in the Hands of Nonstate Actors', Brookings Institute, p. 8.

1.1. Terminologjia dhe interpretimi

Në kontekstin e këtij raporti, terminologjia e përshtatur në paketën ligjore mbi sigurinë kibernetike dhe strukturat e mekanizmat rregullues do të pranohet dhe citohet sikundër përcaktohet në këtë paketë ligjore. Në vijim, ky raport ofron një përpjekje për interpretimin dhe përkufizimin e termave specifikë që ende debatohen në diskursin ndërkombëtar mbi rreziqet dhe sulmet kibernetike dhe sulmet kibernetike terroriste.

Kërcënimi kibernetik mund të kuptohet si <u>një rrethanë ose ngjarje me potencial për të ndikuar negativisht në veprimtarinë operative të institucioneve, asetet ose individët nëpërmjet aksesit të paautorizuar në sisteme për shkatërrimin, zbulimin dhe modifikimin e informacionit dhe/ ose mohimin e shërbimit publik</u>[15].
Në këtë drejtim, kërcënimi për sulme kibernetike terroriste ndaj infrastrukturës kritike merr rëndësi specifike[16].

Rrezik i sigurisë kibernetike, një ngjarje e identifikueshme me efekt të mundshëm negativ për sigurinë e rrjeteve e të sistemeve të informacionit.

Sulm kibernetik mund të kuptohet si "përdorim i hapësirës kibernetike me qëllim të ndërprerjes, çaktivizimit, shkatërrimit ose kontrollit me qëllim dëmtues dhe kriminal të një mjedisi/ infrastrukture kompjuterike; ose shkatërrim i integritetit të të dhënave ose vjedhja e informacionit të kontrolluar"[17]. Sulmi kibernetik mund të kuptohet, gjithashtu, si një ngjarje ose situatë që shkakton dështim të sistemeve elektronike të TIK-ut, që kërcënon për dëm serioze për mirëqenien e njerëzve, mjedisin, ofrimin efektiv të shërbimeve kritike publike ose sigurinë kombëtare[18].

Ndaj, në kontekstin e këtij raporti, një sulm kibernetik i referohet në mënyrë specifike atyre veprimeve të qëllimshme, të paligjshme dhe domethënëse që depërtojnë, shfrytëzojnë dhe/ose ndikojnë ose cënojnë infrastrukturën kritike, shërbimet thelbësore dhe funksionimin efektiv të qyteteve, me implikime tek qytetari si përdorues fundor i strukturave dhe shërbimeve (pavarësisht autorit të sulmit).

Termi **"terrorizëm kibernetik"** u krijua në fund të viteve 1980 që kombinon sëbashku terrorizmin dhe hapësirën kibernetike[19]. Në kontekstin e sulmeve të Qendrës Botërore të Tregtisë në 1993, bombardimeve në Oklahoma në 1997 dhe bombardimeve të ambasadave të SHBA në Kenia dhe Tanzani në 1998, hapësira kibernetike u pa si një vektor potencial për të cënuar shoqëritë e lidhura përmes internetit. Në këtë sfond, referenca e parë për këtë çështje vjen përmes një dokumenti politik "*Terrori kibernetik: Perspektivat dhe Implikimet*" (1999) [20], i cili është studimi i parë gjithëpërfshirës që trajtoi

[15] Computer Security Resource Centre Glossary (no date). 'Cyber threat'. (Accessed online).
[16] United Nations (2017). Security Council Resolution 2341. (Accessed online).
[17] Computer Security Resource Centre (no date). 'Cyber Attack' definition, National Institute of Standards and Technology.
[18] Lobel-Weiss, N., Gould, T. (2019). London Cyber Incident Response Framework, London Resilience, p. 5.
[19] Emery, N.E. (2005). 'The Myth of Cyberterrorism', Journal of Information Warfare, 4(1), pp. 80-89
[20] Nelson, B., Choi, R., Iacobucci, M., Mitchell, M., Gagnon, G. (1999). 'Cyberterror: Prospects and Implications', Defense Technical Information Center, Fort Belvoir, VA.

terrorizmin kibernetik[21].

Ndryshe nga sulmet konvencionale terroriste, terrorizmi kibernetik nuk kërcënon domosdoshmërisht përmes dhunës, njerëzit ose infrastrukturën fizike[22]. Këto sulme mund të jenë operacione që synojnë të prishin ose shkatërrojnë pronën digjitale. Konteksti gjeopolitik në fund të shekullit të 20-të, si dhe fillimi i digjitalizimit dhe debatet rreth "shoqërisë së informacionit", katalizuan më tej konceptin e terrorizmit kibernetik. Menjëherë pas sulmit terrorist të 11 shtatorit në SHBA, një grup hakerash i quajtur Dispatchers njoftoi se do të sulmonte shtetet që mbështesin terroristët. Ky grupim ndërhyri dhe shkatërroi qindra faqe interneti dhe nisi sulme (Distributed Denial-of-Service/DDoS) kundër shteteve të tilla si Irani apo Afganistani, për të treguar kapacitetin ndikues dhe aftësitë e tyre[23]. Tre vjet më vonë, një botim tjetër, *'Terrorism in the Information Age: New Frontiers'*[24] theksoi cenueshmërinë e infrastrukturës kritike ndaj sulmeve dhe demonstroi interesin e terroristëve për të synuar "site" të tilla. Kohët e fundit, koncepti i terrorizmit kibernetik është studiuar gjerësisht akademikë, media, autoritetet qeveritare dhe komuniteti ndërkombëtar, veçanërisht në aspektin e valës së sulmeve 'ransomware' që synojnë ose prekin operatorët kritikë të infrastrukturës, siç ndodhi me qendrat spitalore në Francë dhe Irlandë, apo sistemet e furnizimit me karburantet dhe industria e përpunimit të mishit në SHBA[25]. Këto raste treguan sesi impakti në popullatë mund të tejkalojë shumë shpejt limitet e instrastrukturës kritike.

Pavarësisht kontekstualizimit praktik të terrorizmit kibernetik, sfida mbetet në lidhje me klasifikimin dhe dallimin e këtij akti kriminal nga krimet e tjera kibernetike. Edhe në rastet kur shtetet janë përpjekur ta përfshijnë në legjislacionin e brendshëm terrorizmin kibernetik, nuk janë ofruar dallime të qarta krahasuar me taktikat e tjera terroriste[26]. Ky fakt u theksua edhe nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2021, përmes avancimit të praktikave shtetërore për zbulimin, hetimin dhe ndëshkimin e këtij akti kriminal.

Terrorizmi i mundësuar nga hapësira kibernetike: orientohet nga rastet kur hapësira kibernetike shërben si lehtësues për kryerjen e akteve terroriste, për të theksuar rëndësinë e përhapjes së sulmeve kibernetike nga grupet terroriste. Mjetet për një sulm të tillë mund të prekin komunitete e vendbanime, thjesht, për shkak të sistemeve kibernetike të dobëta, ndaj përgatitja për çdo rast shndërrohet në

[21] Soesanto, S. (2020). 'Cyber Terrorism: Why it exists, Why it doesn't, and Why it Will', Real Instituto Elcano

[22] Denning, D.E. 'A View of Cyberterrorism Five Years Later', Internet Security: Hacking, Counterhacking, and Society. Edited by K. Himma (Sudbury, MA: Jones and Bartlett Publishers, 2007).

[23] Denning, D. (2001). 'Is Cyber-Terror Next?', Social Science Research Council. (Accessed online).

[24] Nicander, L., Ranstorp, M. (2004). 'Terrorism in the Information Age: New frontiers?', Swedish National Defence College.

[25] Boholm, M. (2021). 'Twenty-five years of Cyber Threats in the News: A study of Swedish newspaper coverage (1995-2019)', Journal of Cybersecurity, 7(1), (Accessed 15 November 2021); 'Cyber Terrorism and Public Support for Retaliation – A Multi-Country Survey Experiment', British Journal of Political Science, pp. 1-19; Soesanto, S. (2020). 'Cyber Terrorism'.

[26] Broeders, D., Cristiano, F., Weggemans, D. (2021). 'Too Close for Comfort: Cyber Terrorism and Information Security across National Policies and International Diplomacy', Studies in Conflict and Terrorism, 0, pp. 1-28. (Accessed 15 November 2021); Denning, D.E. (2001). 'Activism, Hacktivism, and Cyberterrorism: The internet as a tool for influencing foreign policy', Networks and Netwars: The Future of Terror, Crime, and Militancy. Edited by J. Arquilla and D. Ronfeldt (Rand Corporation); Flemming, P., Stohl, M. (2001). 'Myths and Realities of Cyberterrorism'

prioritet kombëtar. Përmes rasteve nga kontekste dhe sisteme të ndryshme, ky raport synon të rrisë ndërgjegjësimin për përgatitje paraprake dhe nevojën për plane vendore që parandalojnë sulmet kibernetike terroriste. Rritja dhe pasojat e sulmeve kibernetike – veçanërisht sulmet "*ransomware*" – tregojnë se rreziku rritet nga varësia e shoqërisë dhe ndërvarësia me sistemet e bazuara në hapësirën kibernetike.

Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare (CSIS) ofron disa ilustrime përmes listës së sulmeve kibernetike që shoqërohen me pasoja të rënda: në 2015, ofruesi i telekomunikacionit TalkTalk raportoi prekjen e të dhënave që zbuloi rreth 157,000 regjistrime të klientëve, i cili u shoqërua me një email "virus" dhe një kërkesë për shpërblim[27]. Në vitin 2017, sulmi "WannaCry" shpërtheu në të gjithë globin dhe shkatërroi pjesë të Shërbimit Shëndetësor Kombëtar të Mbretërisë së Bashkuar (NHS). Në vitin 2021, një sulm dëmtoi dhe nxori jashtë funksionit tubacionet qendrore të furnizimit me karburant në bregun lindor të Amerikës; një tjetër sulm në distancë u përpoq të helmonte furnizimin me ujë të një qyteti në Florida duke rritur sasinë e hidroksidit të natriumit[28], dhe Coop Sweden mbyllën 665 dyqane pasi pikat e shitjes dhe vetë-shërbimit ndaluan së punuari për shkak të infiltrimit në software, dhe bllokimit të shitjeve. Rasti i fundit është vetëm një pjesë e impaktit global që pati kjo industri tek përdoruesit dhe që thekson dimensionin ndërkombëtar të kërcënimit kibernetik. Sipas CSIS, vetëm në muajin janar 2024 u ndërmorën mbi 15 sulme kibernetike ndaj agjencive qeveritare kanadeze, suedeze, australiane; kompanive të mbrojtjes dhe të teknologjisë, ose bizneseve ndërkombëtare, duke pësuar humbje miliona dollarshe[29].

Hapësira kibernetike është përdorur për qëllime të paligjshme nga terroristët; ai mund të shërbejë gjithashtu si një mjet për sulmet terroriste, si dhe një shërbim (mundësues) i drejtpërdrejtë për lehtësimin e këtyre sulmeve. Terrorizmi i nxitur nga hapësira kibernetike ka potencialin të përhapë frikë, të krijojë panik në popullsi ose të detyrojë një qeveri ose organizatë ndërkombëtare të bëjë (ose të heq dorë) nga politika ose veprime institucionale. Numri i shembujve dhe skenarëve të sulmeve kibernetike tregon se si sulmet DDoS, fushatat e *ransomware, phishing,* manipulimi i të dhënave dhe prishja e faqeve të internetit mund të jenë tërheqëse për terroristët.

[27] UK Government (2016). 'National Cyber Security Strategy 2016-2021', p. 20. (Accessed online).

[28] BBC (2021). 'Hacker Tries to Poison *ater Supply of Florida Cty', (8 February). (Accessed online)

[29] Centre for Strategic and International Studies. 'Significant Cyber Incidents'. (Accessed online).

Kjo tendencë në rritje e ka detyruar Departamentin Amerikan të Drejtësisë të theksojë prioritetet dhe rëndësinë e hetimit të ransomware njëlloj si për terrorizmin[30]. Ky perceptim i sulmeve *ransomware*, edhe kur kryhen nga grupe kriminale, tregon gravitetin me të cilin ato shihen dhe ndikimin që mund të kenë. Nëse një sulm kibernetik është në shkallë ndërkombëtare, kombëtare ose lokale; me fokus të përcaktuar (individual, organizativ ose rajonal); ose i përhapur (organike dhe sporadike e bazuar në software ose sisteme etj.), mund të ketë pasoja të rëndësishme që shfaqen në të gjitha nivelet e shoqërisë. "Darkweb", për shembull, ofron anonimitet dhe mundësi për t'u fshehur nga ana e aktorëve keqdashës dhe shërben si një hapësirë diskutimi, koordinimi dhe veprimi ndërmjet tyre. Ai mund të lehtësojë shkëmbimet ndërkombëtare ndërmjet grupeve armiqësore, të mundësojë akses në forma të panumërta të produkteve të paligjshme dhe shërbime kriminale. ISIS dihet se ka hakuar llogaritë e Twitter[31], për shembull, dhe hetime të shumta e operacione kundër terrorizmit kanë treguar përdorimin e enkriptimit nga Al-Kaeda dhe individë të lidhur me ISIS-in, duke komunikuar më shpejt, gjerësisht dhe fshehurazi për të nxitur terrorin në një shkallë më të gjerë[32]. Rekrutimi, radikalizimi, mbledhja e fondeve, shpërndarja e propagandës dhe inkurajimi i dhunës ose mundësimi i sulmeve fizike drejtohen përmes kanaleve online. Në një shembull, 4 website false nga një grup i njohur islamik përdorin kripto-monedhën për të financuar sulmet terroriste.[33]

Kjo qasje kombinohet me shkëmbime të ndërsjella ekspertize dhe trajnimesh kibernetike; platforma të botës së krimit në "darkweb" që kapërcejnë kufijtë; rrjete klandestine; dhe një mikro-ekonomi e ndërtuar mbi kripto-monedha[34]. Ndërmjet vitit 2016-2017, ISIS nisi serinë e parë të suksesshme të sulmeve DDoS, të koordinuara nëpërmjet një hapësirës "darkweb" dhe duke synuar kryesisht infrastrukturën qeveritare. U raportua se ISIS kishte përdorur një shërbim DDoS-for-hire, duke treguar lidhjen midis krimit kibernetik dhe terrorizmit të nxitur nga hapësira kibernetike [35].
Modeli "krimi-si-shërbim" ngre shqetësimin ndaj grupeve terroriste me aftësi të ulëta për blerjen e shërbimeve apo algoritmeve të para-

[30] Bing, C. (2021). 'Exclusive: U.S. to Give Ransom*are Hacks Similar Priority as Terrorism', Reuters. (Accessed online).

[31] Hymas, C. (2019). 'ISIL Terrorists Hack Ordinary Peoples' Dormant Twitter Accounts', The Telegraph (18 November). (Accessed online).

[32] UNOCT (2021). 'Algorithms and Terrorism: The malicious use of artificial intelligence for terrorist purposes. A Joint Report by UNICRI and UNCCT', pp. 17-18. (Accessed online).

[33] Greenberg, A. (2020). 'ISIS Allegedly Ran a Covid-19 PPE Scam Site'. (Accessed online).

[34] US Department of Justice (2012). 'Assistant Attorney General for National Security Lisa Monaco Speaks at the "2012 Cybercrime Conference"'. (Accessed online).

[35] Flashpoint (2017). 'Cyber Jihadists Dabble in DDoS: Assessing the threat'. (Accessed online).

ndërtuara për qëllimet e tyre kriminale. Qendra Evropiane e Krimit Kibernetik tani ofron ekspertizë për hetime ku krimi kibernetik dhe terrorizmi ndërlidhen me njëra-tjetrën[36]. Që nga viti 2017, divizioni për hakerim i ISIS ka pretenduar (shënim: sfidat në vlerësimin e besueshmërisë së pretendimeve janë një pengesë tjetër për të kuptuar origjinën e sulmeve kibernetike) përgjegjësinë për sulmet që prishën shërbimet online[37] dhe Europol ka raportuar thirrje të tjera nga grupet terroriste për sulme kibernetike kundër objektivëve të ndjeshëm[38].

[36] Europol (2021). 'European Union Terrorism Situation and Trend report', p. 105. (Accessed online).
[37] UNOCT (2021). 'Algorithms and Terrorism', p. 27. (Accessed online).
[38] Europol (2021). 'European Union Terrorism Situation and Trend report', p. 59. (Accessed online).

Haktivizmi politik. konsiderohet si një lloj terrorizmi kibernetik ose hakerimi, sidomos nga shtete të caktuara nën maskën e goditjes së fënomeneve politike. Disa nga përkufizimet më të përhapura që ndihmojnë për të kuptuar fenomenin janë këto:

- "përdorimi jo i dhunshëm i mjeteve dixhitale të paligjshme ose ligjërisht të paqarta në ndjekje të qëllimeve politike" (Samuel, 2004)
- "Një kombinim i protestës politike me bazë hakerimin kompjuterik" (Jordan dhe Taylor, 2004)
- "Një veprim i motivuar politikisht, në internet, ose një fushatë komjuterike e ndërmarrë nga një aktor joshtetëror në shenjë hakmarrjeje për të shprehur mosmiratimin ose për të tërhequr vëmendjen ndaj një çështjeje politike" (Vegh, 2003)

Haktivizmi - si një përdorim i motivuar politikisht i aftësive hakeruese, të ndërmarra nga aktorë anonimë joqeveritarë, për të përhapur fjalën, për të tërhequr vëmendjen për një çështje dhe për të shkaktuar ndryshim. Këto janë pikat kyçe që ndihmojnë për të dalluar haktivizmin nga hakerimi, terrorizmi kibernetik dhe aktivizmi online. Për të siguruar një kuptim më të mirë se çfarë ndikimi politik mund të ushtrohet nga haktivistët, së pari duhet të studiojmë stimujt që qëndrojnë pas aktiviteteve haktiviste.

2. Cenueshmëria dhe ndërvarësia

2.1. Infrastruktura kritike e informacionit

Sulmet kibernetike në infrastrukturën kritike mund të shkaktojnë efekte dytësore dhe terciare zinxhir që, në disa raste, shkaktojnë më shumë dëme kolaterale sesa vetë sulmi. Në referim të kuadrit tonë rregullator, me "infrastrukturë kritike të informacionit" kuptohet tërësia e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit, të zotëruara nga një autoritet publik ose privat, që ofrojnë shërbime, cenimi apo shkatërrimi i të cilave do të kishte impakt serioz në shëndetin, sigurinë, mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe funksionimin efektiv të ekonomisë në Republikën e Shqipërisë. Për të ilustruar me disa shembuj mbi impaktin dhe efektet zinxhir të sulmeve kibernetike përmendim rastin e Shqipërisë, në mars 2021, kur sulmi kibernetik që synoi paralizimin e shërbimeve publike dhe fshirjen e plotë të informacioneve nga databaza shtetërore; solli si pasojë publikimin e të dhënave personale të qytetarëve dhe zyrtarëve shtetërorë. Në maj 2021, fushata e ransomware kundër kompanisë së naftës dhe gazit "Colonial Pipeline" në SHBA goditi sistemet e IT-së të biznesit dhe fatmirësisht jo fluksin e tubacionit, presionin dhe metrika të tjera. Megjithatë, meqë informacioni mbi pagesat, porositë e blerjes dhe inventari nuk u prekën, kompania u detyrua të përdorë disa sisteme jashtë linje, duke përfshirë tubacionet kryesore. Ky vendim bëri jehonë në ekosistemin amerikan dhe çoi në ndërprerje të shpërndarjes, panik dhe mungesën e furnizimit në shumë pika karburanti [39]. Kërkesa e shoqërive për karburant do të thotë se një destabilizim i tillë mund të ketë efekte të gjera në funksionimin e qyteteve, zinxhirin e furnizimit, ekonominë dhe madje edhe në tregjet ndërkombëtare.

Efekte të tjera pati një fushatë ransomware në Spitalin Universitar të Düsseldorf-it (Gjermani) në shtator 2020. Ransomware infektoi sistemin kompjuterik që përdorej për të koordinuar turnet e mjekëve, operacionet kirurgjikale, trajtimin mjekësor dhe menaxhimin e pacientëve sipas shtretërve. Duke qenë se këto të dhëna u bllokuan, spitalit iu desh të anullonte mijëra operacione, të kufizonte në mënyrë drastike kapacitetin e tij për të trajtuar pacientët dhe të ndalonte të gjitha pranimet e reja. Mbyllja efektive e spitalit solli raportimin e 2 humbje jetësh (një grua 78-vjeçare me aneurizëm të aortës, në pritje të operimit; dhe një rast vetëvrasjeje në mungesë të prezencës së mjekut roje). Ngjarjet u hetuan nga prokuria, e cila argumentoi se vdekja e parë ndodhi për shkak të gjendjes shëndetësore dhe

> "Infrastruktura kibernetike mbështet infrastrukturën kritike si termocentralet, hidrocentralet dhe sistemet e ujësjellës kanalizimeve, qendrat shëndetësore dhe spitalore, sistemet e telekomunikacionit, rafineritë e naftës dhe gazit dhe rrjetin e transportit dhe rrugët kombëtare."
>
> *Agjencia e Sigurisë Kibernetike dhe Sigurisë së Infrastrukturës (SHBA) "Korniza e Planifikimit të Qëndrueshmërisë së Infrastrukturës"*

[39] Krauss, C. et al. (2021). 'Gas Pipeline Hack Leads to Panic Buying in the South-east', The New York Times (11 May). (Accessed online).

jo nga sulmi i *ransomware*. Kryeprokurori publik përgjegjës për hetimin, megjithatë, vuri në dukje rastin si "një shenjë paralajmëruese për ata që menaxhojnë infrastrukturën kritike" se dështimi për të mbrojtur në mënyrë adekuate këto sisteme "mund të përfundojë në rezultate fatale" [40].

Në të vërtetë, sulmet kibernetike ndaj kujdesit shëndetësor mund të kenë pasoja serioze, siç tregohet nga sulmi WannaCry që ndikoi në sistemin shëndetësor në Mbretërinë e Bashkuar.

2.2. Rast studimor - Sulmi WannaCry ransomware

Të premten, më 12 maj 2017, një sulm global ransomware, i njohur si WannaCry, preku një gamë të gjerë qytetesh dhe sektorësh. WannaCry infektoi kompjutera që ekzekutonin disa versione të sistemit operativ Microsoft Windows duke shfrytëzuar një dobësi specifike të Windows, duke enkriptuar të dhënat dhe duke kërkuar pagesa shpërblimi në kriptomonedhën Bitcoin. Brenda një dite, Europol raportoi infektimin e më shumë se 250,000 kompjutera në të paktën 150 qytete[41], duke përfshirë sistemet e administratës qendrore së sistemit shëndetësor në Mbretërinë e Bashkuar. Sulmi preku të paktën 80 nga 236 fonde sigurimesh për mbulimin financiar të shërbimeve shëndetësore (truste) në sistemin shëndetësor në të gjithë Anglinë (a) si pasojë e infektimit të disa kompjuterave nga ransomware (b) ose si pasojë e fikjes se pajisjeve si masë paraprake. Rreth 603 qendra të kujdesit parësor dhe agjenci e kabinete shëndetësore u infektuan, duke vënë në rrezik 595 ndërhyrje kirurgjikale. Firma e sigurisë kibernetike Avast e identifikoi WannaCry si një nga sulmet kibernetike më të gjera dhe më të dëmshme në histori. Përveçse është sulmi më i madh kibernetik që ka prekur sistemin shëndetësor kombëtar në Mbretërinë e Bashkuar deri më sot, ndikimi i WannaCry u regjistrua deri në Rusi, Ukrainë dhe Tajvan, në universitetet kineze, tek firmat spanjolle Telefónica dhe firmat globale si FedEx, Nissan dhe Renault[42].

- **Përgjigjet e Sistemit Kombëtar Shëndetësor britanik**

Shërbimi Dixhital CareCERT i Sistemit Kombëtar Shëndetësor njoftoi Departamentin e Shëndetësisë rreth orës 13.00 më 12 maj 2017, pas raportimeve të shumta nga trustet e NHS. Sulmi u përcaktua si një incident i madh ndaj sistemit kombëtar shëndetësor (NHS) në orën 16.00, duke garantuar zbatimin e një strukture komandimi dhe kontrolli kombëtar sipas planeve ekzistuese të Emergjencave, Gatishmërisë, Qëndrueshmërisë dhe Reagimit. NHS e Londrës veproi si pika e vetme e koordinimit për menaxhimin e incidenteve me mbështetjen e Shërbimit Digjital dhe Shërbimeve Mbështetëse. ora 17:00, qendrat rajonale të koordinimit të incidenteve në NHS filluan të kërkonin konfirmime nga organizatat lokale të NHS se veprimet po ndërmerreshin në përputhje me komunikimet CareCERT. Organizatat lokale punuan për të zgjidhur dhe parandaluar sulmin kibernetik ku ishte e mundur. Më vonë në mbrëmjen e 12 majit 2017, një ekspert zbuloi versionin "kill switch" që ndaloi përhapjen e mëtejshme të *malware*. Shërbimi Digjital u shkroi të gjitha trusteve më 14 maj 2017 për të

[40] Ralston, W, (2020). 'The Untold Story of a Cyberattack, a Hospital and a Dying Woman', Wired (Accessed online).

[41] CNBC (2017). 'Unprecedented Cyber-Attack Hits 200,000 in At Least 150 Countries, and the Threat Is Escalating'. (Accessed online).

[42] Larson, S. (2017). 'Massive cyberattack targeting 99 countries causes sweeping havoc'. CNN. (Accessed online).

mos kryer asnjë pagesë si shpërblim për rikthimin e të dhënave.[43]

Përgjigja e NHS ndaj sulmit u formulua nga tre faza:

- Mbrojtja e kanaleve për urgjencat shëndetësore;
- Qëndrueshmëria dhe operavionaliteti i kujdesit parësor;
- Riparimi i dëmeve, veprime më të gjera të sistemit dhe aplikimi i përditësimit antivirus.

Në përputhje me planet ekzistuese për reagimin ndaj incidenteve të mëdha, NHS fillimisht u përqendrua në mirëmbajtjen e shërbimeve të urgjencës. Koha e sulmit, duke filluar të premten, rezultoi në ndërprerje minimale të shërbimeve të kujdesit parësor, të cilat zakonisht mbyllen gjatë fundjavës. Sulmi WannaCry ndërpreu shërbimet e NHS në të gjithë vendin deri më 19 maj 2017, kur incidenti kombëtar u bllokua. Gjatë kësaj periudhe, Departamenti i Shëndetësisë dhe NHS Angli punuan me NHS Digjital, Qendrën Kombëtare të Sigurisë Kibernetike, Agjencinë Kombëtare të Krimit dhe të tjerë për t›iu përgjigjur sulmit dhe për të mbështetur shërbimet e NHS në ofrimin e kujdesit për pacientët. NHS Angli zbatoi planet e incidenteve të mëdha dhe koordinoi reagimin përmes të njëjtave ekipe dhe struktura që do të merreshin me çdo incident tjetër të madh kombëtar. Kjo ishte një kornizë e fortë përmes së cilës mund të menaxhohej incidenti.

➢ Impakti dhe mësimet e nxjerra

Kujdesi shëndetësor është një mjedis kompleks me shumë sisteme të lidhura. NHS iu përgjigj në mënyrë efektive këtij incidenti madhor, pa raportime për dëme ose humbje jetësh të pacientëve, pa cënim të të dhënave të pacientëve apo vjedhje të të dhënave. Është vlerësuar nga NHS Angli se 1% e aktivitetit të NHS u ndikua drejtpërdrejt nga sulmi WannaCry gjatë javës së sulmit. Nga 236 fonde sigurimesh për mbulimin financiar të shërbimeve shëndetësore (truste) në të gjithë Anglinë, 80 u prekën rëndë, duke prekur shërbimet pavarësisht nëse sistemi nuk ishte e infektuar nga virusi (për shembull, nëse u përdorën serverat e postës elektronike ose lidhjet e rrjetit jashtë linje). Disa pajisje mjekësore kritike po përdornin ende software Microsoft Windows 7 ose XP të ofruar nga palë të treta; këto pajisje u prekën, duke përfshirë, për shembull, skanerat e rezonancës magnetike (MRI) dhe pajisjet e analizave të gjakut. Rezultati ishte se

[43] National Audit Office. 'Investigation: WannaCry cyber-attack and the NHS'. (Accessed online).

pajisjet diagnostikuese u bënë të papërdorshme pasi software funksiononte në një pajisje të infektuar dhe duhej të rregullohej ose karantinohej. NHS Angli identifikoi se 6,912 takime ishin anuluar dhe rreth 19,000 takime referimi u prekën (fshinë, ndryshuan). Nuk dihet se sa konsulta mjekësore janë anuluar, apo sa ambulanca dhe pacientë janë devijuar nga pesë departamentet e urgjencës që nuk kanë mundur të trajtojnë disa pacientë. NHS Angli thotë se është e pamundur të llogaritet me siguri ndikimi financiar i sulmit WannaCry. Një vlerësim i përgjithshëm flet për 92 milion £, duke përfshirë shërbimin dhe kostot e IT nga sulmi.[44]

Pas sulmit kibernetik të WannaCry, u ndërmor një seri takimesh informuese ndërmjet agjencive, vlerësime të brendshme organizative. Bordi Udhëheqës i Sigurisë së të Dhënave të Departamentit të Shëndetësisë ngarkoi gjithashtu Zyrtarin e Lartë të Informimit për sistemin e kujdesit shëndetësor dhe social në Angli për të kryer një rishikim gjithëpërfshirës të sulmit. Zyra Kombëtare e Auditimit hetoi gjithashtu efektin që kishte sulmi WannaCry në NHS në Angli.

Disa nga rekomandimet kryesore janë paraqitur më poshtë:

Vlerësimi i Zyrtarit të Lartë të Informimit arriti në përfundimin se sulmi theksoi dobësitë brenda NHS në Angli. Ai ekspozoi nevojën për të përmirësuar të gjithë sistemin NHS, duke përfshirë disiplinën dhe përgjegjshmërinë rreth sigurisë kibernetike në nivel të lartë drejtues dhe bordi, dhe rëndësinë e përgjigjes së shpejtë dhe efektive të sistemeve kur bëhen përditësimet e reja të sigurisë. Vlerësimi identifikoi investime të ulëta për sigurinë e rrjetit dhe software të përditësuar.

Një nga mësimet kryesore ishte nevoja për qartësi mbi udhëheqjen dhe përgjegjësinë për çdo incident të ardhshëm të sigurisë kibernetike. Kjo u trajtua përmes zhvillimit të një "udhëzuesi kibernetik" për të përshkruar qasjen dhe veprimet që duhen ndërmarrë nga NHS Angli, NHS Improvement dhe NHS Digital në rast të një sulmi kibernetik.
Në parim, Departamenti i Shëndetësisë do të drejtonte përgjigjen e sistemit. Vlerësimi rekomandoi zhvillimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit, reagimit kibernetik dhe rikuperimit të katastrofave të organizatave lokale për të përfshirë detajet e nevojshme rreth incidenteve kibernetike. Kjo përfshiu vlerësimin e ndikimit të humbjes së shërbimeve në pjesë të tjera të sistemit të kujdesit shëndetësor dhe social.[45] Vlerësimi gjithashtu theksoi se planet duhet të testoheshin rregullisht nëpër organizata dhe partnerë lokalë, me mbikëqyrje në nivel bordi. Shërbimi Shëndetësor Digjital përgatiti një Test Reagimi ndaj Incidentit Kibernetik[46] për të mbështetur organizatat lokale në testimin e reagimit ndaj incidenteve në kujdesin shëndetësor dhe social.

Nevoja për të ndërtuar fleksibilitetin e organizatave lokale u nxit më tej nga rekomandimet për zhvillimin e ofruesve dhe shërbimeve digjitale; mbrojtjen e pacientit; heqjen ose izolimin e sistemeve të pambështetura dhe versioneve të pambrojtura të software; investimet në infrastrukturë.

Rekomandimet për të përmirësuar infrastrukturën dhe planifikimin lokal u shoqëruan me zhvillimin menaxherial të qeverisjes. Kjo do të thoshte se të gjitha organizatave të NHS tani iu kërkua të caktonin një drejtor ekzekutiv si drejtues i sigurisë së të dhënave; Rreziqet e sigurisë kibernetike duhet të rishikoheshin rregullisht nga bordi; dhe duhet të merreshin masat e duhura si kundërpërgjigje për të zbutur

[44] UK Government. (2018) 'Securing Cyber Resilience in Health and Care: October 2018 update'. (Accessed online).

[45] NHS England (2018). 'Lessons Learned Revieë of the WannaCry Ransomware Cyber Attack'. (Accessed online).

[46] NHS Digital. Cyber Incident Response Exercise (CIRE). (Accessed online).

ose zvogëluar ndikimet e një sulmi tjetër ndërkohë që shërbimi ishte gjatë restaurimit.[47]

U bënë përpjekje për transformimin dixhital të gjithë shërbimit NHS, duke përfshirë përgjegjësitë për ofrimin e drejtimit strategjik dhe monitorimin e sigurisë kibernetike. Një punë e rëndësishme u ndërmor gjithashtu për të zhvilluar sistemin shëndetësor digjital CareCERT, i cili tani ka evoluar në sistemin "*Respond to an NHS cyber alert*", i cili lejon dërgimin e mesazheve tek organizatat shëndetësore dhe ato të kujdesit social, siguron konfirmimin e marrjes dhe merr përditësime mbi progresin me punën e rehabilitimit.

Është e pashmangshme që sistemet shëndetësore dhe të kujdesit social të përballen me sulme në të ardhmen. Kjo kërkon vigjilencë dhe një proces vlerësimi dhe menaxhimi të këtyre kërcënimeve.
Si të tilla, DH dhe NHS vazhdojnë të investojnë në sigurinë kibernetike në të gjitha nivelet. Ndërsa peizazhi i kërcënimit evoluon vazhdimisht dhe sistemet dixhitale bëhen gjithnjë e më të fokusuara në ofrimin e kujdesit shëndetësor për publikun, ka pasur përmirësime në tre fusha kryesore: monitorimi kibernetik, inteligjenca ndaj kërcënimeve dhe reagimi ndaj incidenteve; mbështetje dhe udhëzime për organizatat lokale; plus trajnimin kibernetik, ndërgjegjësimin dhe angazhimin me praktikat më të mira të sigurisë kibernetike.

[47] NHS England (2018). 'Lessons Learned Revie* of the *annaCry Ransom*are Cyber Attack'. (Accessed online).

2.3. Sulmet kibernetike me të cilat është përballur Shqipëria

Qasja e Shqipërisë ndaj sigurisë kibernetike ndahet në dy periudha:

1. rrjedhjet e të dhënave para vitit 2022[48];
2. rrjedhjet e të dhënave dhe sulmeve kibernetike pas vitit 2022.

Në vitin 2022, rreth 1 milion sulme kibernetike shënjestruan Shqipërinë, ku 80% e tyre e kishin origjinën nga Irani[49]. Sulmi ndaj infrastrukturës kritike të Shqipërisë paralizoi vendin, i cili sapo kishte përfunduar tranzicionin e ofrimit të një numri të konsiderueshëm të shërbimeve publike vetëm online. Qëllimi dhe synimi i sulmit ishte tërësisht brenda përkufizimit të termit të veprave penale në kuadër të terrorizmit. Grupi i vetëquajtur HomeLandJustice, i kërkonte shtetit shqitpar që të largonte nga Shqipëria anëtarët e organizatës MEK, e cila është në opozitë me regjimin aktual në Iran. Ky pretendim ngrihej mbi argumentin se MEK kryente veprime të paligjshme ndaj Iranit dhe për këtë qëllim, Shqipëria, duke qenë se kishte garantuar qëndrimin e tyre, mbante përgjegjësi që jo vetëm strehonte një grup të konsideruar terrorist nga Irani por dhe lejonte hapësirën e saj kibernetike për kryerjen e akteve terroriste online.
Pas sulmit, një hetim i përbashkët i FBI dhe Microsoft zbuloi se hakerët e HomeLand Justice ishin infiltruar në sistem 9 muaj para sulmit[50]. Kjo gjetje ishte shqetësuese për sa i përket vulnerabilitetit të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme në vend.

Rrjedhjet e të dhënave personale e zhvendosën fokusin e qeverisë në nevojën kritike për masa më të forta të sigurisë kibernetike, pavarësisht se kur hedhim një vështrim mbrapa për mënyrën se si Qeveria shqiptare trajtoi sulmet kibernetike dhe rrjedhjen e të dhënave, vërejmë se ska asnjë element të ri apo ndryshim në metodologjinë e përdorur. Qasja më së

[48] Të dhënat e rreth 910,000 shqiptarëve në listën e Patronazhistëve; të dhënat personale dhe pagat për 637,138 qytetarë shqiptarë, dhe informacioni privat për targat e makinave dhe numrat e telefonit për 650,000 shqiptarë u zbuluan dhe u bënë pjesë e domenit publik.

[49] https://kohajone.com/flet-mbreti-i-sigurise-kibernetike-shqiptare-igli-tafa/

[50] https://www.cisa.gov/news-events/cybersecurity-advisories/aa22-264a

shumti ka qenë e fokusuar se “i kujt është faji” sesa “masat që duhen marrë për të evituar përsëritjen në të ardhmen e afërt” apo kryerjen e analizave mbi impaktin social që kanë pasur këto sulme dhe dëmet e drejtpërdrejta që ju janë shkaktuar qytetarëve, paralelisht me analizën e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturat e informacionit, infrastrukturat kritike apo rrjeteve te komunikimit. Këto lloj analizash zakonisht duhet të kryhen nga të gjithë aktorët si ata institucionalë, publikë, jo-publikë, OJF-të, ekspertët e fushës së TIK, përfaqësues të akademisë apo dhe ekspertët ndërkombëtarë në bashkëpunim me njëri-tjetrin në mënyrë që të ndërtohen plane për përgjigje të koordinuar ndaj sulmeve të mëdha kibernetike dhe plane përgatitjeje multidimensionale me hapa konkrete me qëllim mitigimin e rasteve të sulmeve kibernetike apo rrjedhjes së informacioneve konfidenciale, sensitive apo sekret shtetëror.

Në kohën kur ndodhi sulmi kibernetik, Shqipëria po kalonte në një model të qeverisjes tërësisht elektronike duke ofruar shërbimet publike vetëm online, nëpërmjet sistemeve kompjuterike të informacionit[51]. Nga ana tjetër, Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2020-2025 pranonte mungesën e mjeteve të nevojshme të Qeverisë për të siguruar inteligjencë kibernetike për veprimtarinë e organeve ligjzbatuese dhe mungesën e burimeve njerëzore me aftësitë dhe kualifikimet e duhura për të adresuar sfidat e sigurisë kibernetike. Edhe pse synimi ishte “garantimi i sigurisë kibernetike në nivel kombëtar përmes mbrojtjes së infrastrukturës së informacionit”, realiteti provoi të kundërtën.

Sulmet kibernetike e gjetën Qeverinë duke promovuar arritjet e qeverisjes dixhitale dhe kërkesës së llogarisë së publikut lidhur me këto sulme, Qeveria ju përgjigj duke parashtruar disa argumente ndër të cilat ishin që portali unik qeveritar e-Albania nuk ruan të dhëna; edhe Qeveri të tjera më të forta në aspektin e sigurisë kibernetike janë sulmuar nga sulme të tilla apo si dhe, ne bëmë më të mirën që kishim mundësi.

Nëse i referohemi në mënyrë të përmbledhur sulmeve kibernetike të kryera në Shqipëri në një hark kohor prej pothuajse dy vitesh, evidentohet se në shumicën e rasteve të dëmtuarit kryesorë janë qytetarët, qofshin këta të veshur me pozicione publike apo qytetarë të thjeshtë, përdorues shërbimesh publike dhe jo-publike.

[51] Aktualisht është miratuar një ligj i ri për qeverisjen elektronike. Ligji Nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”.

- Në datë 15 Korrik 2022[52], hacker-ët shkaktuan ndërprerje të përkohshme në faqet e internetit të Zyrës së Kryeministrit të Shqipërisë dhe Parlamentit, si dhe në portalin unik qeveritar e-Albania i përdorur për të aksesuar dhe përdorur shërbimet publike.

- Në shtator 2022, hackerët iranianë synuan sistemet kompjuterike shqiptare, duke detyruar zyrtarët shqiptarë të mbyllin përkohësisht Sistemin e Përgjithshëm të Menaxhimit të Informacionit, një shërbim i përdorur për të ndjekur individët që hyjnë dhe dalin nga Shqipëria. Ky sulm u shoqërua ngushtë me vendimin e Shqipërisë për të shkëputur lidhjet diplomatike me Iranin, siç edhe Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, njoftoi në një deklaratë video[53] se një seri sulmesh shkatërruese në infrastrukturën dixhitale kritike të vendit në fillim të verës ishin atribuar Republikës Islamike të Iranit (IRI), dhe si rezultat, qeveria po ndërpriste marrëdhëniet diplomatike me Teheranin si dhe me sanksionet amerikane dhe dënimin e NATO-s për një sulm kibernetik iranian kundër Shqipërisë në korrik. Në sulmin e korrikut, aktorët iranianë vendosën ransomware në rrjetet e Qeverisë Shqiptare që shkatërroi të dhëna dhe shkaktoi ndërprerje në shërbimet qeveritare.

- Më 19 shtator 2022, dymbëdhjetë ditë pasi Shqipëria ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Republikën Islamike të Iranit, HomeLand Justice publikoi në kanalin e tyre të Telegramit një dokument prej 47 faqesh të të dhënave të vjedhura. Dosja përmbante informacion personal identifikues si dhe regjistrime të kalimeve kufitare të ish-drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit të Shqipërisë, Gledis Nano, dhe familjes së tij.

- Më pak se një muaj më vonë, më 3 tetor, i njëjti grup HomeLand Justice publikoi një dokument tjetër voluminoz, këtë herë me madhësi mbi 1.7 gigabajt, i cili ekspozonte 300 identitete të personave të dyshuar për vepra penale në Shqipëri. Kjo shpërndarje të dhënash sugjeron fort se hakerët kishin hyrë në sistemin e avancuar të komunikimit të policisë së Shqipërisë të quajtur Memex[54], duke ngritur shqetësime të forta për masat e mbrojtjes së të dhënave kombëtare.

- Pas tyre, vazhduan rrjedhje periodike të informacionit. Më 19 tetor, hakerët publikuan një dosje lidhur me drejtorin e inteligjencës shqiptare, Helidon Bendo, që përmbante të dhëna prej 17 vjetësh (2005-2022) nga Sistemi i Përgjithshëm i Menaxhimit të Informacionit (TIMS), duke ekspozuar përsëri hyrjet dhe daljet e regjistruara në kufirin shtetëror.

- Më 2 nëntor, grupi rriti rrezikun sërish duke publikuar identitetet dhe detajet personale të 600 oficerëve të inteligjencës shqiptare, duke përfshirë emrat, email-et dhe numrat e telefonit.

---

[52] https://www.csis.org/programs/strategic-technologies-program/significant-cyber-incidents

[53] https://www.kryeministria.al/en/newsroom/videomesazh-i-kryeministrit-edi-rama-lidhur-me-vendimin-e-qeverise-shqiptare-si-kunderpergjigje-ndaj-aktit-te-sulmit-te-rende-kibernetik-ndaj-infrastruktures-digjitale-te-qeverise-se-republikes-se-s/

[54] https://albanianpost.com/bie-sistemi-me-i-sofistikuar-i-komunikimit-policor-homeland-justice-vijon-publikimet-e-materialeve/

- Gjashtë ditë më pas, HomeLand Justice publikoi një video të një operacioni të inteligjencës shqiptare në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, që përfshinte pamje të ish-shefit të policisë Nano.

Siç u bë e qartë nga deklarata e kryeministrit shqiptar më 7 shtator, sulmet kibernetike dhe rrjedhjet e informacionit në fillim të vjeshtës nuk ishin hera e parë që grupi i hakera-ve HomeLand Justice bëhej i njohur në vend. Më parë, hakerët e lidhur me këtë grup kishin vjedhur korrespondencën e shkëmbyer ndërmjet ministrive, ambasadave, dhe madje edhe email-at e Kryeministrit me qytetarë shqiptarë. Çdo herë, grupi e bënte këtë të ditur në Telegram. Dhe më 15 korrik, sulmuesit kibernetik njoftuan në Twitter se kishte në plan të kryente sulme kibernetike kundër Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit të Shqipërisë (AKSHI) siç edhe ndodhi.

- Në 25 dhjetor 2023[55], grupi HomeLand Justice arriti të depërtojë tek të dhënat e kompanisë së telekomunikacionit 'One', kompanisë ajrore 'Air Albania' si dhe sulmuan faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.

- Më datë 1 shkurt 2024[56], Instituti i Statistikave është përballur me një sulm kibernetik nga grupi HomeLand Justice që synonte infrastrukturën e tij teknologjike dhe që ka shkaktuar dëme të konsiderueshme në të dhëna.

Nga një vlerësim i riskut për rastin e mësipërm mund të thuhet se:

Shqipëria mund të konsiderohet "hotspot" i krimeve kibernetike me natyrë terroriste: *Shqipëria aktualisht është subjekt i sulmeve kibernetike me natyrë terroriste por mund të rrezikoj të jetë një territor i cili mund të përdoret nga organizata të ndryshme për të kryer veprime terroriste kibernetike ndaj shteteve të tjera.*

Rritja e sulmeve të ngjashme: *Ky sulm mund të shërbejë si shembull për grupet e tjera terroriste të cilat mund të dëshirojnë të ndjekin shembullin dhe të kryejnë sulme të ngjashme në të ardhmen. Kjo rrit mundësinë e përhapjes së sulmeve të këtij lloji dhe përdorimin e taktikave të ngjashme të dëmshme në Shqipëri.*

Rritja e tensioneve ndërkombëtare: *Sulmet kibernetike të tilla kanë çuar në prishjen e marrëdhënieve ndërkombëtare midis vendeve dhe të çojnë në tensione të mëtejshme diplomatike dhe politike edhe me shtete të tjera jo miqësore me Shqipërinë siç është dhe rasti i Rusisë.*

Rënia e besimit publik në sigurinë kibernetike: *Sulmet kibernetike të tilla mund të shkaktojnë një rënie të besimit publik në sigurinë kibernetike dhe në aftësinë e qeverisë për të mbrojtur infrastrukturën kritike nga këto rreziqe.*

[55] https://boldnews.al/2023/12/25/one-albania-nen-kthetrat-e-homeland-justice-hakerat-sulmojne-kompanine-celulare/
[56] https://cesk.gov.al/deklarate/

Gatishmëria për t'iu përgjigjur sulmeve kibernetike duhet të jetë proporcionale me rrezikun, shkallën dhe llojet e shërbimeve që ofrohen

Një fushatë ransomware që synonte rrjetin ICT të transportit publik të Torontos në tetor 2021 shkaktoi mbylljen e sistemit të brendshëm të postës elektronike. Rezervimet në internet u bllokuan dhe sistemi i komunikimit me operatorët u fshi[57]. Operatorët e automjeteve kaluan në radio për të komunikuar me Qendrën e Kontrollit dhe udhëtarët u nxitën të bënin rezervime me telefon. Përgjigja shmangu ndërprerje të rëndësishme të shërbimit dhe nënvizoi rëndësinë e planifikimit të lidhjeve të qëndrueshme të komunikimit. Megjithatë, incidenti rezultoi në humbjen e mundshme të informacionit personal të 25,000 punonjësve aktualë dhe të mëparshëm.[58] Në mungesë të masave të reagimit elastik, një sulm i tillë mund të përballet me një rrjet transporti me sfida të vështira logjistike dhe operacionale. Nga kjo rrjedh se gatishmëria për t'iu përgjigjur sulmeve kibernetike duhet të jetë proporcionale me rrezikun, shkallën dhe llojet e shërbimeve që ofrohen.

Një sulm brenda infrastrukturës së mundësuar nga hapësira kibernetike mund të ketë efekte të rëndësishme "zinxhir". Sikur të marrim në konsideratë se si transporti (ajror, detar dhe ujor, hekurudhor dhe rrugor), stacionet e energjisë ((elektrike dhe bërthamore), impiantet e trajtimit të ujit dhe ujërave të zeza, sistemet e ashensorëve dhe shkallëve lëvizëse, semaforët, sistemet e gazit apo fibrat e telekomunikimit në distanca të gjata janë kryesisht të automatizuara. Ndërsa kalojmë në makina pa shofer, kamionë, autobusë dhe shtëpi inteligjente ose ndërtesa plotësisht të automatizuara me sisteme ngrohjeje, ajrimi, ajri të kondicionuar, ndriçimi dhe hidraulik, sipërfaqja e sulmit do të rritet. Ndërsa infrastruktura kritike bëhet gjithnjë e më dixhitale dhe e ndërlidhur, nevoja për t'u siguruar që ajo është e mbrojtur nga e ardhmja bëhet më urgjente.

Komunikimet – veçanërisht komunikimet satelitore – janë bërë thelbësore për komunikimin, pozicionimin gjeohapësinor, monitorimin e mjedisit, lidhjet e të dhënave dhe mbrojtjen, gjë që ngre shqetësime në lidhje me cënueshmërinë e saj ndaj kërcënimeve të tilla si sulmet kibernetike".[59]

Shërbimet bazë për komunitetin

Aktorët armiqësorë duke përfshirë terroristët mund të përdorin vjedhjen e të dhënave dhe grumbullimin e të dhënave, për shembull, për të studiuar, planifikuar dhe mbështetur sulmet e jetës reale (fizike). Rasti në vijim është identifikuar për të treguar se cenimi i shërbimeve komunitare mund të krijojë efekt zinxhir që sjell impakt të gjerë social.
Në rastin e hakerimit të të dhënave 10-vjeçare për rreth 200 punonjës policie, qendra trajnimi, struktura mbështetëse etj., publikimi i këtyre të dhënave në mesin e vitit 2020 nxiti rreziqe specifike të haktivizmit politik. Pas trazirave dhe protestave në shumë qytete të SHBA për vrasjen e George Floyd, DDoSecrets publikoi 270 GB të dhëna, të njohura si "BlueLeaks"

[57] CBC (2021). 'Toronto Transit System Hit by Ransom*are Attack, TTC Says No Significant Disruptions', The Canadian Press (29 October). (Accessed online); CBC (2021). 'TTC CEO Apologizes in the *ake of Ransom*are Attack', CBC Ne*s (5 November). (Accessed online).
[58] *arrick, J. (2017). 'Use of *eaponized Drones by ISIS Spurs Terrorism Fears', *ashington Post. (Accessed online).

[59] Pescaroli, G. et al (2018). 'Increasing Resilience to Cascading Events: The M.OR.D.OR. scenario', Safety Science 110(C), Elsevier, p. 134. (Accessed online).

në qershor 2020.[60] Të dhënat dolën nga «hakerimi më i madh i publikuar i agjencive amerikane ligjzbatuese dhe ofruan informacione të detajuara të agjencive shtetërore, lokale dhe federale të ngarkuara me mbrojtjen e publikut, duke përfshirë përgjigjen e qeverisë ndaj Covid-19 dhe protestave "BlackLiveMatters". Edhe pse DDoSecrets fshiu afërsisht 50 GB të dhëna sensitive në lidhje me viktimat e krimit, fëmijët, kujdesin shëndetësor dhe shoqatat e veteranëve, mendohet se ka ende te dhëna të tjera që janë fshirë përfundimisht. Të përfshira në miliona skedarë janë të dhënat personale të më shumë se 700,000 punonjësish të agjencive ligjzbatuese në SHBA, historitë e fjalëkalimeve, faturat, emrat e informatorëve, hartat e detajuara të incidentit, videot dhe skedarët audio, materialet e trajnimit dhe shumë më tepër. Me këtë volum materiali, sigurisht që do të ketë kompromise të operacioneve të ndjeshme dhe ndoshta edhe burime njerëzore ose të infiltruarve në rrezik. Çdo operacion i krimit të organizuar ka të ngjarë të ketë kërkuar emrat e tyre përpara se zbatimi i ligjit të dijë se çfarë ka në dosje, kështu që dëmi mund të bëhet shpejt dhe të jetë i rëndë.[61]

Megjithëse ende nuk dihet se si janë marrë saktësisht skedarët BlueLeaks, dy aspekte janë të rëndësishme: a) sipas Qendrës Kombëtare të Fusionit, "Analiza paraprake e të dhënave që përmban kjo rrjedhje sugjeron se "Netsential", një kompani shërbimesh në internet e përdorur nga shumë agjenci ishte burimi i kompromentimit dhe b) përpjekjet hetimore zbuluan përdorimin e një teknike të zakonshme hakerimi për të fituar akses të gjerë në bazat e të dhënave dhe nxjerrjen e skedarëve[62]. Pas publikimit të këtij raporti, BlueLeaks mbetet në dispozicion të publikut. Në një shembull tjetër, në mars 2000, Aum Shinrikyo u zbulua se kishte software që gjurmonte 150 automjete policie. Është një pyetje e hapur nëse kjo formë e haktivizmit antiqeveritar mund të karakterizohet si një formë e veçantë e terrorizmit të nxitur nga hapësira kibernetike, pasi mund të përdoret për oficerë të veçantë të organeve ligjzbatuese apo dhe anëtarë të publikut.

[60] Greenberg, A. (2020). 'Hack Brief: Anonymous Stole and Leaked a Megatrove of Police Documents', Wired (22 June). (Accessed online).

[61] Brian Krebs (2020). '"BlueLeaks" Exposes Files from Hundreds of Police Departments', KrebsOnSecurity (22 June). (Accessed online).

[62] Lee, M. (2020). 'La* Enforcement Websites Hit by BlueLeaks May Have Been Easy to Hack', The Intercept (19 August). (Accessed online).

2.4. Rast studimor - Sulmi i ransomware ndaj të dhënave mjekësore të COVID-19

Më 28 dhjetor 2020, në Antwerp, u zhvillua një sulm kibernetik që kishte në shënjestër Laboratorin e Përgjithshëm Mjekësor (AML), që analizonte rezultatet e testit Covid-19. Që herët, ishte e qartë se ky ishte sulm *ransomware*, me qëllim shantazhin për përfitime financiare. Në atë kohë, AML, një kompani private, trajtonte rreth 3,000 teste Covid-19 në ditë, ose rreth 5% të totalit kombëtar. Si e tillë, ishte një nga laboratorët më të mëdhenj privatë në vend që merrej me krizën Covid-19[63]. Një pjesë e madhe e rezultateve laboratorike, që përmbanin të dhëna për rreth një milion pacientë u bllokuan. Publikimi i të dhënave në këmbim të një shpërblimi është një formë moderne shantazhi, por asnjë e dhënë nuk arriti të përdorej. 10 ditë para sulmit të ransomware, laboratori ra pre e një sulmi tjetër kibernetik, në të cilin u gjetën malware në serverat e tij. Që nga kjo datë, e në vijim, kishte shqetësime për sulme të mëtejshme dhe akses të mundshëm të të dhënave sensitive në lidhje me Covid-19. Prandaj, sapo AML përjetoi sulmin e dytë, ajo shkëputi rrjetin e internetit. Disa javë më vonë u bë e qartë se disa laboratorë të tjerë mjekësorë (në Genk, Moeskroen, Brugge en Ardooie) kishin rënë pre e të njëjtit sulm ransomware dhe kishin pësuar pasoja të ngjashme. Që nga kjo datë, e në vijim, kishte shqetësime për sulme të mëtejshme dhe akses të mundshëm të të dhënave sensitive në lidhje me Covid-19. Prandaj, sapo AML përjetoi sulmin e dytë, ajo shkëputi rrjetin e internetit.

Disa javë më vonë u bë e qartë se disa laboratorë të tjerë mjekësorë (në Genk, Moeskroen, Brugge en Ardooie) kishin rënë pre e të njëjtit sulm ransomware dhe kishin pësuar pasoja të ngjashme.
Studimet tregojnë se sapo kompanitë sulmohen nga ransomware, mentaliteti i tyre ndryshon befas. Shumica e kompanive investojnë në parandalimin e sulmeve të reja. Çuditërisht, kjo mund të çojë në më shumë incidente[64]. Kjo është ndoshta për shkak të nivelit më të lartë të alarmit për kërcënimet e mundshme dhe përdorimit efektiv të sistemeve kundër sulmeve kibernetike. Kompanitë dhe qeveritë punësojnë më shumë specialistë të TIK, duke shpresuar se kjo do të jetë e dobishme kur të sulmohen përsëri ose kur shihen pasojat. Instalimi i sistemeve më të mira është i lidhur ngushtë me rritjen e sigurisë kibernetike dhe investimin më shumë në parandalimin e sulmeve në internet.

Impakti psikologjik

Ndërveprimi për parandalimin e sulmeve kibernetike, duke u konsideruar si profile që kërkojnë njohuri të thelluara, mund të zhvillojë një aspekt psikologjik që kërkon vëmendje më të madhe, veçanërisht në kontekstin e terrorizmit të nxitur nga hapësira kibernetike. Trajtimi i pikave të dobëta të TIK mund t›i verë stafet para niveleve të larta të stresit, për një periudhë të gjatë. Në këtë mënyrë, taktikat kundërshtare mund të ndikojnë – sipas planit ose rastësisë – në shëndetin psikologjik të stafit dhe të tjerëve.[65]

[63] (2020).'Antwerps laboratorium doelwit van ransomware', Computable (29 December).

[64] (2020). 'Ransomware-aanval verandert mentaliteit bedrijven', Computable (15 October).

[65] Chaudhury, D. (2020). 'Ransomware Is Taking a Psychological Toll on Cyber Security Experts', ITSecurity Wire, (3 November). (Accessed online); Collier, K. (2021). 'Barely Able to Keep Up: America's cyberwarriors are spread thin by attacks', NBC News (8 July). (Accessed online); Palmer, D. (2021). 'Ransomware Attacks Against Hospitals Are Having Some Very Grim Consequences', ZDNet (29 September). (Accessed online); Ranger, S. (2020). '"The Most Stressful Four Hours of My Career": Hoë it feels to be the victim of a hacking attack', ZDNet (26 June). (Accessed online).

Efekt të fortë psikologjik patën sulmet ransomware gjatë pandemisë Covid-19, duke goditur gjithçka, nga spitalet dhe shkollat tek administratat e qytetit dhe kompanitë private. Kombinimi i stresit, pafuqisë për t'u përgjigjur dhe urgjencës për të rikthyer sistemet ka kontribuar në dëshirën e shumë viktimave për të paguar shpërblimin më shpejt se në kushte jo-pandemike[66]. Deri më sot, janë bërë pak studime për këto efekte psikologjike të vazhdueshme dhe rezonuese që mund të shfaqen para, gjatë dhe pas një sulmi të madh kibernetik.

Megjithatë, mund të jetë në vetvete një taktikë për t'i bërë sulmet kibernetike më të suksesshme (për shembull, përmes lodhjes dhe stresit ndaj atyre që mbrojnë rrjetet). Profesionistët e sigurisë kibernetike, si rezultat i punës së bazuar në kibernetikë, kanë raportuar se kanë përjetuar efekte psikologjike si çrregullimi i stresit post-traumatik (PTSD).

Një grup i parë studimesh psikologjike dhe histori personale të viktimave të krimit kibernetik ofrojnë një perspektivë në natyrën e këtyre implikimeve. Analiza nga Qendra për Studime kundër Mashtrimit tregon se disa viktima të krimit kibernetik ndihen të dhunuara, sikur sulmi të ishte fizik dhe raportojnë ndikime psikologjike si zemërimi, ankthi, frika, izolimi dhe turpi[67]. Këto emocione mund të çojnë në një prishje afatgjatë të marrëdhënieve themelore të besimit, një frikë të përgjithshme nga vetë teknologjia ose në rrethana ekstreme edhe vetëvrasje.

Studimet në Qendrën e Krimeve Kibernetike të Kembrixhit sugjerojnë se "në varësi të asaj se kush janë sulmuesit dhe viktimat, efektet psikologjike mund të rivalizojnë edhe ato të terrorizmit tradicional[68]".

Profesionistët e sigurisë kibernetike, që janë përballur drejtpërdrejt me përpjekje për të mbajtur rrjetin dhe të dhënat e kompanisë së tyre të sigurta, ka të ngjarë të përjetojnë efekte psikologjike. Efekte të tilla, në hakerimin e një siti finlandez lidhjesh

[66] Wilkie, C. (2021). 'Colonial Pipeline Paid $5 million Ransom One Day After Cyberattack, CEO tells Senate', CNBC (8 June). (Accessed online).

[67] Ranger. '"The Most Stressful Four Hours of My Career"

[68] Guynn, J. (2020). 'Anxiety, Depression and PTSD: The hidden epidemic of data breaches and cyber crimes', USA Today (21 February). (Accessed online).



online të terapisë Vastaamo në 2020, zbuluan informacione personale shumë të ndjeshme që shkatërruan shumë familje, çuan në vetëvrasje dhe prishën jetën e shumë të tjerëve. Të lidhura me këtë ndikim të drejtpërdrejtë psikologjik janë shqetësime të tjera mbizotëruese të kujdesit shëndetësor në komunitetin e sigurisë kibernetike që shpesh çojnë në lodhje në punë apo probleme të shëndetit mendor. Kushtet kontribuese përfshijnë mungesën e qëndrueshme të aftësive të sigurisë kibernetike (mungesa e personelit dhe qarkullimi i lartë); orë të gjata pune (stafi i mbingarkuar dhe rënia e lartë e fuqisë punëtore); kërkesa për vigjilencë të vazhdueshme (duke shkaktuar nivele të larta stresi); dhe një peisazh gjithnjë në rritje të kërcënimit kibernetik që rezulton në lodhje vigjilente[69].

Lodhja për shkak të gjendjes së përhershme të gatishmërisë kundër sulmeve është ndoshta fenomeni më interesant në këtë kontekst, sepse mund të shfaqet në kohë më të gjata të reagimit - me pasoja shkatërruese. Kjo lidhje është disi e keqpërcaktuar në literaturën akademike, por përgjithësisht pranohet se është një kombinim i desensibilizimit dhe mbingarkesës njohëse për shkak të kompleksitetit dhe sasisë së sinjalizimeve hyrëse; reagimi ndaj sinjalizimeve të veprueshme dhe humbja e kohës në ndjekjen e drejtimeve të rreme; dhe frika e vazhdueshme për të humbur një incident. Provat në lidhje me lodhjen e alarmit dërgojnë një sinjal të fortë për kompanitë dhe qeveritë që të kujdesen për stafin e sigurisë kibernetike nga perspektiva e shëndetit mendor dhe sigurisë.[70]

Përballja me rrjetet sociale

Rrjetet sociale po marrin gjithmonë e më tepër hapësirë përdorimi kryesisht tek moshat e reja por jo vetëm. Që me lindjen e rrjetit Facebook (i pari që mori një dimension global) lindi një domosdoshmëri e masës për të qenë i pranishëm në një realitet

[69] Hinkley, C. (2019). 'Preventing PTSD and Burnout for Cybersecurity Professionals', DarkReading (16 September). (Accessed online).

[70] Microsoft (2021). 'Decoding NOBELIUM: The Docuseries – Episode 4 After-Action Report'. (Accessed online).

social virtual. Ky trend u pasua nga Instagram dhe Tiktok ku numri i përdoruesve po rritet dita-ditës. Viti 2023 u mbyll me rreth 3 miliard përdorues të platformës Facebook[71], 1.35 miliard të platformës Instagram[72] dhe 800 milion të platformës Tiktok[73]. Përtej numrit të lartë të përdoruesve të rrjeteve sociale, një indikator i rëndësishëm edhe aktiviteti i përdoruesve të këtyre rrjeteve. Për vitin 2023, në platformën Facebook kemi një mesatare ditore prej 2 miliard përdoruesish aktive [74].

Ky numër kaq i lartë i llogarive në botë bën të kuptohet që shumë prej llogarive disponohen edhe nga mosha shumë të reja.

Aktiviteti i këtyre rrjeteve sociale jo gjithmonë ka një natyrë beninje. Me shqetësim vërehet një trend në rritje në aktiviteteve malinje gjatë përdorimit të rrjeteve sociale kryesisht si mashtrimi, shantazhimi dhe bullizim i përdoruesve të ndryshëm. Në veçanti:

- Mashtrimi ka si qëllim marrjen e informacioneve personale apo sensitive me anë të teknikave të "social engineering". Kjo mund të përdoret nga grupe kriminale për të përvetësuar informacione personale të cilat mund të cenojnë sigurinë e ambienteve të punës ku ato punojnë. Përdoruesi është parë gjithmonë si një hallkë e dobët për të cenuar një sistem kompjuterik. Sipas një studimi të IBM[75] dy sulmet që sëbashku zënë 31% të të gjitha sulmeve janë "phishing" dhe kredencialet e vjedhura. Një element i rëndësishëm që e mundëson mashtrimi është mundësia e "impersonifikimit" (imitimit) të një individi në rrjetet sociale. Kushdo mund të hapë një llogari me emrin e një personi tjetër, ta popullojë atë me disa nga fotot që lehtësisht mund të gjenden online dhe mashtrojë përdoruesit.

- Shantazhimi mundësohet nga lehtësia dhe nga shpejtësia me të cilën mund të përhapen informacione personale dhe sensitive në rrjetet sociale. Informacioni mund të ndahet nga përdorues identiteti i të cilëve nuk është i njohur (kjo sepse përdoruesit mund të përdorim pseudonime) si dhe informacioni i ndarë është vështirë të eliminohet plotësisht. Këto dy faktorë bëjnë që viktima të bijë pre e kërcënimeve pasi efekti negativ është tejet i lartë.

- Bullizmi mundësohet nga mungesa apo vështirësia e kontrollit të materialeve të publikuara, qoftë multimedial apo tekstual. Këto materiale kthehen një formë sulmi ndaj viktimave veçanërisht kur numri i pjesëmarrësve është i lartë.

Tiktok dhe shqetësimi multi-dimensional

Tiktok është një nga platformat më të reja që po merr një vëmendje të gjerë me përdorues që rriten dita-ditës. Mirëpo, kjo platformë është në qendër të kritikave si në aspektin social ashtu edhe politik për disa arsye:

1. Platforma po merr një përdorim të gjerë kryesisht tek moshat e reja. Megjithëse,

[71] https://www.statista.com/statistics/264810/number-of-monthly-active-facebook-users-worldwide/
[72]https://www.statista.com/statistics/183585/instagram-number-of-global-users/
[73]https://www.statista.com/statistics/1327116/number-of-global-tiktok-users/
[74]https://www.statista.com/statistics/346167/facebook-global-dau/
[75]https://www.ibm.com/reports/data-breach

sipas kompanisë, mosha minimale për të pasur një llogari është mosha 13 vjeç (me përjashtim të disa vendeve që e kanë 14), vërehet një kontroll i munguar i kompanisë ndaj përdoruesve më të mitur të cilët janë aktiv në platformë qoftë duke publikuar materiale video qoftë në shkëmbimin e mesazheve me audiencën.

2. Materialet e publikuara ndahen me ndjekësit që cilët aksesojnë publikimet pa ndonjë konsensus paraprak. Ndryshe nga platforma Facebook apo Linkedin e cila u mundëson aksesin vetëm përdoruesve të cilët e kanë kërkuar në formë eksplicite këtë të drejtë (të ashtuquajturit "friends"), platforma Tiktok përdor përqasjen e "followers" (ndjekës). Kjo për të maksimizuar audiencën. Efektin i anësor që kushdo mund të aksesojë dhe komentojë materialet e ndara me ndjekësit. Platforma është në pronësi të kompanisë Kineze ByteDance e cila dyshohet se mbledh të dhëna sensitive të përdoruesve për tua vënë në dispozicion qeverisë Kineze. Për këtë arsye, disa vende të BE-së kanë përcaktuar një ndalim të pjesshëm të aplikacionit kryesisht për punonjësit që kanë lidhje me sigurinë apo edhe më gjerë duke përfshirë të gjithë administratën publike.

3. Ndikime në përgatitjen qytetare kundër terrorizmit kibernetik

Qytetet janë mjedise urbane komplekse – një gjurmë gjeografike me një masë njerëzish, industri dhe infrastrukturë që kryqëzohen në shtresa të ndërvarura të strukturave, sistemeve dhe shërbimeve. Ato shpesh përcaktohen nga shtrirja e tyre urbane (përhapja e strukturave të ndërtuara) dhe/ose shkalla e urbanizimit (*pjesa e popullsisë lokale që jeton brenda kufijve të qytetit*).[76] Përbërja e një qyteti zakonisht përfshin një përqindje relativisht të lartë të industrisë dhe dendësisë së popullsisë, autoritetet kombëtare dhe lokale, si dhe vende të profilit të lartë (si objektet qeveritare, infrastruktura kritike, pikat e nxehta turistike dhe vendet kulturore, arsimore etj). Qytetet kanë ndikim të rëndësishëm politik dhe ekonomik dhe autoriteteve u kërkohet të mbajnë dhe të kryejnë funksione jetësore shoqërore. Funksionet jetësore të shoqërisë në një qytet paraqesin shumë vektorë të sulmeve kibernetike, duke përfshirë infrastrukturën fizike dhe shërbimet software.

> “Ka ardhur koha për një model të ri sigurie që adreson të gjithë procesin në mënyrë holistike– para, gjatë dhe pas sulmit.”
>
> *Gordon Feller*
> *‘Protecting Our Cities from Cyber-Attacks’*

Tre faktorë thelbësorë shërbejnë si nxitës të cënueshmërisë e që ndikojnë në kërcënimin kibernetik në qytete:

1. *Ndërlidhja:* ndërlidhja e infrastrukturave që mjegullon ndarjen midis botës fizike dhe asaj online, u mundëson qyteteve të kontrollojnë dhe qeverisin sistemet teknologjike përmes operacioneve kibernetike në distancë, por kjo gjithashtu zgjeron në mënyrë eksponenciale peisazhin e kërcënimit kibernetik.
2. *Ndërveprimi:* Bashkëjetesa dhe ndërveprimet e shpeshta ndërmjet sistemeve dhe platformave të vjetra dhe të reja mund të krijojnë një ekosistem kibernetik të ndryshëm me dobësi sigurie të fshehura.
3. *Integrimi: Integrimi i teknologjive dixhitale përmes IoT dhe* dhe teknologjive dixhitale do të thotë që një problem në një zonë shërbimi mund të kalojë shpejt në zona të tjera dhe potencialisht të çojë në kërcënime të përhapura.[77]

[76] UN Habitat (no date) ‘*hat is a City?’ Accessed Online.
[77] Pandy, P. et al. ‘Making Smart Cities Cybersecure: ways to address distinct risks in an increasingly connected urban future’, Deloitte, pp. 4-7. (Accessed online).

Revolucioni digjital do të thotë se qytetet po bëhen gjithnjë e më të automatizuara, me një sërë kërcënimesh dhe teknologjish në zhvillim. Përgatitja e qyteteve për sulme kibernetike përfshin detyrën e mundimshme të korrigjimit të një cënueshmërie - për të gjetur një tjetër. Nga kjo rrjedh se aftësia e një qyteti për t'iu përgjigjur kërcënimeve kibernetike varet nga gatishmëria e tij[78]. Gatishmëria përfshin shumë faktorë, disa specifikë për rrethanat lokale, disa të zbatueshëm gjerësisht në shumicën e qyteteve. Në shumë aspekte, gatishmëria dhe qëndrueshmëria e qyteteve janë blloqet ndërtuese për gatishmërinë dhe qëndrueshmërinë e shteteve.

3.1. Siguria kibernetike në qytete

Termi "siguri kibernetike" kërkon aplikim të gjerë në kontekstin e qytetit. Ky term përfshin komunikimin e të dhënave, aksesin në shërbimet shoqërore dhe infrastrukturën kritike që mund të ndikohet nga një sulm kibernetik, si furnizimi me ujë dhe energji elektrike ose transporti.

Në kuptim strategjik, siguria e informacionit, është jetike dhe, një nga masat më të rëndësishme për një qytet për t'u forcuar në një kontekst të sigurisë kibernetike. Imagjinoni sikur dëmet e shkaktuara që ekspozojnë informacione të ndjeshme, vendndodhjet e figurave publike të profilit të lartë, korrespondenca e fshehtë, bazat e të dhënave të shërbimeve të ndërhyrjes së shpejtë, si dhe të dhënat e kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjes sociale të vihen në rrezik për shkak të një sulmi kibernetik. Ekspozime të tilla mund të jenë të rëndësishme dhe të dëmshme, me implikime për autoritetet e qytetit dhe ndoshta sigurinë kombëtare. Mbrojtja e informacionit, sistemeve të të dhënave dhe shërbimeve software zakonisht trajtohet brenda çdo strukture përgjegjëse nëpërmjet ekspertëve të dedikuar të TIK (teknologjisë së informacionit); masat e sigurisë (për shembull, firewalls, filtrat e trafikut, balancimi i ngarkesës dhe ridrejtimi, si dhe infrastruktura e desktopit virtual); verifikimi dhe trajnimi i stafit; dhe marrëveshjet e vazhdimësisë së biznesit.

Thelbi i ndërhyrjes është të identifikohet se çfarë duhet mbrojtur, nga çfarë ka nevojë për mbrojtje dhe në çfarë mënyre ka nevojë për mbrojtje. Tradicionalisht, kjo përgjegjësi qëndron dhe duhet të zbatohet brenda çdo organizate, gjë që është e vështirë për t›u ndjekur dhe mbikëqyrur nga perspektiva e qytetit. Kjo vlen edhe për mbrojtjen e infrastrukturës kibernetike, duke përfshirë sistemet që janë të ndërlidhura, të tilla si rrjetet e rrjetit me fibra optike, por edhe sisteme kryesisht të ndara, siç janë kontrollet industriale për termocentralet. Në mënyrë tipike, këto lloje të infrastrukturës kritike operohen nga ofrues nga autoritetet kombëtare ose lokale ose nga ndërmarrje private.

3.2. Parandalimi dhe mbrojtja

Një mënyrë e qartë për të forcuar parandalimin dhe mbrojtjen është përmes promovimit të një qasjeje të fuqishme nga sektori publik dhe privat, duke kultivuar dhe zbatuar një kulturë parandalimi dhe sigurie dhe duke garantuar që kjo është thelbësore për strategjitë e sigurisë dhe zhvillimin e administratave të qytetit. Në këtë drejtim, qeverisja kibernetike është thelbësore për të vendosur politika dhe rregullore dhe për të ofruar një drejtim të qartë.

[78] Poon, L. (2021). 'What It will Take to Protect Cities Against Cyber Threats', Bloomberg CityLab. (Accessed online).

Disa standarde dhe korniza kyçe të sigurisë kibernetike të BE-së përfshijnë:

- Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave GDPR: Megjithëse nuk është ekskluzivisht një standard i sigurisë kibernetike, Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) përcakton kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale brenda BE-së. GDPR mandaton masat për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, duke përfshirë enkriptimin, anonimitetin dhe kërkesat e njoftimit për incidentin e sigurisë.
- Direktiva NIS: Direktiva e BE-së për sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit (Direktiva NIS) synon të përmirësojë pozicionin e sigurisë kibernetike të operatorëve të infrastrukturës kritike dhe ofruesve të shërbimeve dixhitale brenda BE-së. Ai kërkon që shtetet anëtare të miratojnë strategji kombëtare të sigurisë kibernetike, të krijojnë autoritetet kompetente dhe të vendosin kërkesa për raportimin e sigurisë dhe incidenteve për operatorët e infrastrukturës kritike. Në nivel ndërkombëtar, Direktiva e BE-së për Sigurinë e Rrjetit dhe Informacionit[79] ofron një shembull legjislativ, ku çdo shtet anëtar i BE-së ka filluar të miratojë legjislacionin kombëtar, i cili më pas përputhet me direktivën. Direktiva ka tre pjesë kryesore: aftësitë kombëtare, bashkëpunimi ndërkufitar dhe mbikëqyrja kombëtare e sektorëve kritikë. Për një qytet, kjo kërkon masa aktive dhe menaxhim për të përmbushur detyrimet që rrisin qëndrueshmërinë. Megjithatë, kjo shoqërohet me sfidën e përkthimit të ligjeve dhe politikave në nivel lokal si dhe në të gjithë komunitetet[80].
- ENISA: Agjencia e Bashkimit Evropian për Sigurinë Kibernetike (ENISA) ofron udhëzime, rekomandime dhe praktika më të mira për sigurinë kibernetike përmes publikimeve, raporteve dhe nismave të ndryshme. ENISA mbështet zhvillimin dhe zbatimin e standardeve të sigurisë kibernetike në të gjithë BE-në.
- ISO/IEC 27001: Edhe pse jo specifik për BE-në, ISO/IEC 27001 është një standard i njohur ndërkombëtarisht për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS). Shumë organizata të BE-së miratojnë ISO/IEC 27001 për të krijuar dhe mbajtur praktika efektive të sigurisë kibernetike.
- Akti i sigurisë kibernetike: Akti i BE-së për sigurinë kibernetike ofron një kornizë për certifikimin e produkteve, shërbimeve dhe proceseve të sigurisë kibernetike brenda BE-së. Ai vendos Kornizën Evropiane të Certifikimit të Sigurisë Kibernetike (ECCF) për të promovuar besimin dhe besimin në produktet dhe shërbimet dixhitale.
- Skema e certifikimit të sigurisë kibernetike të BE-së për produktet, shërbimet dhe proceset e TIK-ut: Kjo skemë përshkruan kërkesat dhe kriteret specifike për certifikimin e produkteve, shërbimeve dhe proceseve të sigurisë kibernetike brenda BE-së. Ai synon të harmonizojë certifikimin e sigurisë kibernetike nëpër shtetet anëtare dhe të lehtësojë lëvizjen e lirë të produkteve dhe shërbimeve të certifikuara brenda tregut të BE-së.
- Kuadri Evropian për Certifikimin e Sigurisë Kibernetike (EFC2): EFC2 ofron një kornizë për zhvillimin e skemave të certifikimit të sigurisë kibernetike dhe marrëveshjeve të njohjes reciproke midis shteteve anëtare të BE-së. Ai mbështet krijimin e një tregu të vetëm evropian të certifikimit të sigurisë kibernetike.
- Rregullorja eIDAS: Rregullorja e Shërbimeve të Identifikimit, Autentifikimit dhe Mirëbesimit Elektronik (eIDAS) krijon një kornizë ligjore për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besimit brenda BE-së. Ai përfshin dispozita për vërtetim të sigurt elektronik dhe nënshkrime dixhitale, duke kontribuar në sigurinë kibernetike dhe besimin në transaksionet digjitale.

[79] European Union Agency for Cybersecurity (2021). NIS 2 Directive. https://www.enisa.europa.eu/topics/cybersecurity-policy/nis-directive-new (Accessed online).
[80] Army Cyber Institute. 'Jack Voltaic 3.0', p. 8.

Strategjia e BE-së për sigurinë kibernetike për Epokën Dixhitale "tregon gjithashtu një investim të rëndësishëm në aftësinë e operacioneve të sigurisë kibernetike. Megjithatë, zbatimi në mënyrë të pashmangshme do të jetë i copëtuar dhe do të ofrojë mbrojtje të kufizuar në të gjithë zinxhirët e furnizimit".[81]

Duke kontekstualizuar *Acquis Communnaitaire* në të drejtën e brendshme, duhet theksuar se ndryshimet ligjore mbi sigurinë kibernetike të përgatitura nga Qeveria Shqiptare synojnë të adresojnë boshllëqet e deritanishme në procedura dhe masat e sigurisë. Për një përgjigje sa më efektive ndaj sfidave të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit është e nevojshme një qasje gjithëpërfshirëse në nivel shtetëror dhe më gjerë në nivel ndërkombëtar, që do të përfshinte krijimin e kapaciteteve minimale, por njëkohësisht të larta dhe të mjaftueshme me qëllim planifikimin, shkëmbimin e informacionit, bashkëpunimin dhe detyrimet e përbashkëta të sigurisë për operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit.

Disa nga shkaqet kryesore të identifikuara mund të përmblidhen si më poshtë:

- Mungesa e parashikimeve të qarta ligjore lidhur me subjektet përgjegjëse të sigurisë kibernetike dhe detyrat përkatëse të tyre (CSIRT Kombëtar, CSIRT Sektorial, dhe CSIRT pranë operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit).
- Mungesa e parashikimeve në kuadrin ligjor për ngritjen e një strukture që bën monitorimin e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar.
- Mungesa e parashikimeve ligjore lidhur me trajtimin e gjendjes së situatave emergjente, krizës kibernetike si dhe strukturave përkatëse për menaxhimin e tyre (CERT).
- Mungesa e parashikimeve ligjore për sa i përket hartimit dhe monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike.
- Mungesa e dispozitave lidhur me certifikimin e sigurisë kibernetike dhe procedurat përkatëse.
- Mungesa e parashikimeve të qarta ligjore lidhur me administrimin e sigurisë kibernetike (masat e sigurisë, masat për menaxhimin e riskut, raportimin e incidenteve kibernetike).

Krahasuar me legjislacionin aktual, propozimet ligjore për sigurinë kibernetike në Shqipëri synojnë të përcaktojnë:

- parashikime të qarta ligjore lidhur me subjektet përgjegjëse të sigurisë kibernetike dhe detyrat përkatëse të tyre (autoritetin kombëtar përgjegjës për sigurinë kibernetike, CSIRT-in Kombëtar, CSIRT-et sektoriale, CSIRT-in pranë operatorëve të infrastrukturave të informacionit);
- ngritjen e një strukture që bën monitorimin e sigurisë në nivel kombëtar – Qendra Kombëtare Operacionale e Sigurisë Kibernetike (SOC);
- parashikimin në ligj të ngritjes së një strukture për trajtimin e situatave emergjente dhe gjendjes së krizës kibernetike – Ekipi i Përgjigjes ndaj Emergjencave të Sigurisë Kibernetike (CERT);
- garantimin e sigurisë kibernetike përmes rregullimit të certifikimit të sigurisë kibernetike në përputhje me skemat e certifikimit të Bashkimit Evropian si dhe procedurat e lidhura me to;
- parashikime të qarta ligjore lidhur me administrimin e sigurisë kibernetike, përfshirë forcimin e masave të sigurisë kibernetike, rritjen e mbikëqyrjes në kuadër të zbatimit të tyre, masat për menaxhimin e riskut,

[81] Hill and Creese. 'Why Cyber Resilience Must Be a Top-Level Leadership Strategy', p. 8.

raportimet e incidenteve të sigurisë kibernetike, raportimet vullnetare;
- rritjen e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar për forcimin e sigurisë kibernetike në vend dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare në këtë fushë;

Neni 12 i këtij projektligji, përcakton identifikimin e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, autoritetet përkatëse për identifikimin e tyre, kriteret për identifikim, mënyrën e identifikimit, informacionin që duhet të jepet nga këto subjekte që do të identifikohen si infrastruktura të informacionit si dhe afatin e përditësimit të listës së këtyre infrastrukturave. Gjithashtu, ky nen përcakton se kjo listë mbahet konfidenciale. Ky parashikim vjen si rezultat i të dhënave sensitive që përmban kjo listë, ku përshkruhen emrat e sistemeve e të rrjeteve të infrastrukturave të informacionit. Ruajtja e konfidencialitetit është e domosdoshme për sigurinë e sistemeve të përmendura në të.
Nenet 20 dhe 21 trajtojnë përcaktimin e masave të sigurisë kibernetike, nivelet e tyre, institucionin përgjegjës për miratimin dhe auditimin e zbatimit të këtyre masave, zbatimin apriori të këtyre masave edhe nga ana e subjekteve që operojnë sipas këtij projektligji por që nuk janë ende pjesë e listës së infrastrukturave të informacionit, si dhe masat e ndërmarra nga operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit për menaxhimin e riskut.

Neni 22 parashikon masat e sigurisë kibernetike që merren në rast kërcënimi apo incidenti të sigurisë kibernetike, përkatësisht, masa paralajmëruese, kundërmasa dhe masa mbrojtëse të natyrës së përgjithshme. Por ky projektligj nuk ofron asnjë specifikë për përkthimin e këtyre masave në nivel vendor, për gatishmërinë e domosdoshme që kërkohen për strukturat të cilat operojnë brenda infrastrukturës fizike të një qyteti.

Sërish, qasja sikundër përcaktohet në objektin e këtij projektligji është rregullimi ligjor i përgjigjeve dhe strukturave qendrore dhe jo aq përgatitja qytetare për kërcënimet kibernetike e për më tej, sulmet kibernetike.
Neni 23 përcakton detyrimin e raportimit në rast të incidentit kibernetik nga ana e infrastrukturave të informacionit, afatin kohor për raportim në raste të incidenteve kibernetike, parametrat që duhet të merren parasysh për përcaktimin e rëndësisë së incidentit, raportet që duhen dorëzuar në rast të një incidenti kibernetik si dhe rastin kur të dhënat e administruara në lidhje me incidentet kibernetike vendosen në dispozicion të organizmave ndërkombëtarë në fushën e sigurisë kibernetike.
Klasifikimi i informacionit duket se "filtron" mbrojtjen specifike ndaj kësaj infrastrukture, por në fakt nuk orienton shpjegim mbi impaktin social, ekonomik, psikologjik në rast sulmi kibernetik mbi këto infrastruktura fizike të cilat popullohen nga qytetarë, që ofrojnë dhe marrin shërbime të ndryshme dhe që zakonisht operojnë nën administrimin e pushtetit vendor.
Transformimi teknologjik i ofrimit të shërbimeve në fakt e ka gjetur administratën e pushtetit vendor të papërgatitur për çdo skenar përgatitje, mbrojtje dhe kundërpërgjigje që kërkon zbatimi i këtij projektligji.
Përgatitja e këtij projektligji vjen pas miratimit të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe të planit të veprimit 2020 – 2025[82]; në fakt, duhej të kish ndodhur e kundërta për të rritur zbatueshmërinë dhe ndjekjen hap pas hapi të përgatitjes dhe qëndrueshmërisë qytetare, plotësimit me masa për fushata ndërgjegjësimi vendore; dhe, jo vetëm plotësimin me autoritete, pa përcaktuar një vlerësim të përgjithshëm të impaktit tek qytetari.

[82] Kjo Strategji eshte miratuar me VKM Nr. 1084 datë 24.12.2020

3.3. Qeverisja dhe politikat në mbrojtje të qytetarëve

Siguria kibernetike është e ngjashme me parandalimin e zjarrit; ajo ka nevojë për një qasje sistematike si pjesë e një strategjie afatgjatë do të thotë identifikimi dhe zbutja e dobësive të sistemit; forcimi i masave mbrojtëse të sigurisë dhe rregullimeve të vazhdimësisë për operacionet e qytetit; rritja e kapacitetit dhe aftësisë së agjencive për t'iu përgjigjur dhe rimëkëmbur nga një sulm... ndërkohë që zhvillon dhe integron teknologjinë (duke përdorur komponentë të testuar, të certifikuar dhe të besuar) në qytete dhe infrastrukturë në një mënyrë inteligjente.

Shërbimet e sigurisë kanë paralajmëruar se si qytetet inteligjente janë një objektiv kryesor për sulmet kibernetike, duke theksuar nevojën për të dizenjuar dhe ndërtuar "mjedise fizike të lidhura përmes internetit". Por jo gjithmonë, sistemet dhe pajisjet e integruara në infrastrukturën e qytetit (sistemet e automatizuara, sensorët, komponentët e IoT dhe të tjera) janë "të sigurta nga dizajni dhe struktura ndërtuese". Ndaj, është prioritar zbatimi i qasjeje gjithëpërfshirëse sigurie që bën bashkë teknologjinë e informacionit dhe planifikimin urban, duke synuar modelim të zgjeruar, vlerësim dhe aftësi planifikimi për politikëbërësit dhe autoritetet e sigurisë publike – si kontribut parandalues dhe mbrojtës[83].

Shumë aspekte të jetës komunitare në qytet janë "të lidhura". Ato varen nga sistemet dixhitale që kontrollojnë semaforët, pagesat elektronike, transportin, ujësjellësit, shërbimin e urgjencës mjekësore, stadiumet, tubimet dhe eventet publike etj. Aftësia për të hyrë dhe për të përcjellë informacion gjithashtu varet kryesisht nga platformat dixhitale.

Studimet evidentojnë se "garës së qyteteve dhe shteteve në mbarë botën, për të adoptuar teknologji që automatizojnë shërbimet, i dedikohen incentiva të pakëta për mbrojtjen ndaj sulmet kibernetike". E, për pasojë, edhe përgjigjet ndaj sulmeve është e ndryshme dhe kryesisht fokusohen tek funksionaliteti i teknologjisë dhe jo tek siguria publike[84].

Një shembull për këtë problematikë është rasti kur teknologjia (një dron) është përgjegjës për të kontrolluar sistemin e sensorëve të semaforëve rrugorë dhe lehtësia me të cilën një keqbërës mund të shkaktojë kaos dhe aksidente tek qytetarët përmes hakerimit të këtij droni.

Një shembull tjetër është sulm kibernetik për manipulimin e matësve inteligjentë të energjisë eletrike ndaj qytetarëve, duke krijuar ndërprerje të energjisë elektrike, apo prishje të parametrave duke shkaktuar dëmtime të rënda të aparateve që funksionojnë me energji elektrike tek përdoruesi fundor[85].

Ky është rasti i gabimit në software në disa shtete amerikane në gusht 2003, e cila rezultoi në mungesën e energjisë elektrike për 10 milionë njerëz, incidente dytësore dhe vdekje. E njëjta gjë ndodhi në dhjetor 2015 në Ukrainë, kur 225,000 klientë u prekën nga një ndërprerje e energjisë e shkaktuar nga aktorë keqdashës që kishin

[83] National Cyber Security Centre (2021). '10 Steps to Cyber Security'. (Accessed online).
[84] Wong, S. (2015). 'Cyber Attack: How easy is it to take out a smart city?', New Scientist. (Available online).
[85] ENISA (2021). 'ENISA Threat Landscape for Supply Chain Attacks', European Union Agency for Cyber Security. (Accessed online).

depërtuar në sistemet e kontrollit industrial për të fikur 30 nënstacione. Konsiderohet se furnizimi me energji elektrike është shtylla kurrizore e të gjitha funksioneve të shoqërisë. Është thelbësore për ofrimin e shërbimeve dhe nxitës i sjelljes individuale dhe kolektive [86].

Mbrojtja efektive e veprimtarisë funksionale të qyteteve dhe garantimi i shërbimeve komunitare për qytetarët kërkon jo vetëm përgjigje por përgatitje, sistematike, progresive dhe të vazhdueshme që ndërgjegjeëson çdo qytetar për të ndihmuar në reduktimin e forcës së sulmit, apo në rastin më të mirë, në devijimin e forcës së sulmeve kibernetike.

Kështu, përmendim Nju Jorkun, qytet i cili në vitin 2021 raportoi të ishte qyteti i parë me një qendër operacionale kibernetike, të gatshme për të shkëmbyer informacione në kohë reale dhe për t'u përgatitur për kërcënimet e mundshme kibernetike.

3.4. Rast Studimor – Qendra operacioneve kibernetike e New York-ut

Më 1 Prill 2019, Zyra e Prokurorit të Qarkut të Nju Jorkut, Departamenti i Policisë së qytetit të Nju Jorkut, Komanda Kibernetike e qytetit të Nju Jorkut dhe Aleanca Globale Kibernetike përuruan Qendrën e Shërbimeve dhe Infrastrukturës Kibernetike të Nju Jorkut (NYC CCSI). NYC CCSI është një bashkëpunim i profesionistëve nga njësitë publike dhe private në të gjithë sektorët e infrastrukturës kritike, që bashkohen për të luftuar kërcënimet nga kundërshtarët, në nivel global. Në vitin 2021, New York City u bë zona e parë e madhe metropolitane që hapi një qendër operacionale kibernetike, të gatshme për të shkëmbyer informacione në kohë reale dhe për t'u përgatitur për kërcënimet e mundshme kibernetike. Ajo përbëhet nga më shumë se 280 anëtarë nga 80 organizata në 12 sektorë të ndryshëm. Misioni i NYC CCSI është të ndajë informacione për kërcënimet në kohë reale dhe të dhëna të tjera përkatëse (p.sh. tregues të kompromisit), të trajnojë dhe të vendosë vullnetarë nëse një njësi ekonomike ose sektori kërkon ndihmë të specializuar.

Anëtarët e NYC CCSI janë në komunikim të vazhdueshëm nëpërmjet një kanali tw dedikuar për të siguruar që informacioni i vlefshëm po ndahet nëpër sektorë. NYC CCSI ka mbajtur disa seanca trajnimi kibernetik, ku anëtarë nga të gjithë sektorët marrin pjesë dhe kontribuojnë. Këto trajnime janë mbajtur në X-Force Cyber Range të IBM në Kembrixh, Massachusetts. Me këtë trajnim, partnerët ndanë informacione të vlefshme për kërcënimet dhe angazhohen në një sërë stërvitjesh. Bashkëpunimi i sektorëve të ndryshëm i lejon qytetit të parandalojë sulmet e mundshme kibernetike dhe të jetë gati nëse ndodh një sulm.
Gjatë pandemisë, kjo agjenci zhvilloi një seri diskutimesh me partnerë kryesorë të agjencive të sigurisë si Agjencia e Sigurisë Kibernetike dhe Sigurisë së Infrastrukturës (CISA). NYC CCSI synon të rrisë komunikimin dhe koordinimin ndërmjet sektorëve për të mbrojtur jo vetëm qytetin e Nju Jorkut, por infrastrukturën kritike në të gjithë botën përmes partnerëve globalë që përfshijnë, si Tribunal de Paris, Agjencinë për Parandalimin e Krimit Kibernetik (Liban), Europol, Departamenti Federal i Drejtësisë në Zvicer dhe Policinë e Londrës (ScotlandYard).

[86] Pescaroli, G., Turner, S., Gould, T., Alexander, D., Wicks, R. (2017). 'Cascading Impacts and Escalations in Wide-Area Power Failures', UCL IRDR and London Resilience Special Report 2017-01, Institute for Risk and Disaster Reduction, University College London, p. 4.

Ekziston nevoja për të zhvilluar marrëveshje të integruara që shoqërohen nga një grup mjetesh për të vlerësuar më mirë dobësitë në kontekstin e kërcënimeve kibernetike dhe AI. Për më tepër, një kornizë e integruar e rrezikut kibernetik për kërcënimet aktuale dhe të ardhshme, që përfshin standardet e industrisë, kërkesat ligjore dhe administrative dhe parimet e menaxhimit do t'u siguronte qyteteve një mjet për transformim[87] në drejtim të parandalimit, mbrojtjes dhe gatishmërisë.

[87] Pandy, P. et al. 'Making Smart Cities Cybersecure', p. 9.

3.5. Përgatitja përmes qasjes multi-agjenci

Gatishmëria përqendrohet në zhvillimin e planeve, procedurave dhe aranzhimeve të shumë agjencive për t'iu përgjigjur vetë sulmit kibernetik, si dhe për të reduktuar pasojat e tij. Ajo duhet të përfshijë gjithashtu mënyra të organizuara për të testuar masat mbrojtëse dhe të konsiderojë përdorimin e iniciativave krijuese, si p.sh. hackathon-et ose aktivitete të ngjashme për të forcuar sigurinë kibernetike. Këto lloje ngjarjesh po përhapen gjerësisht sepse promovojnë ndërgjegjësimin dhe bashkëpunimin, si dhe ofrojnë një mjet për të ekspozuar dhe adresuar dobësitë.

Integrimi i një planifikimi progresiv që gjeneron aftësinë për të operuar pa sisteme të caktuara dixhitale (për shembull, dokumentimi i mënyrës se si do të ndodhin vendimmarrja dhe veprimet) është thelbësor në reduktimin e ndikimit të një sulmi kibernetik. Ka të ngjarë që disa rreziqe të jenë shumë komplekse për t'u mbrojtur plotësisht, ose mbrojtja do të ishte shumë e shtrenjtë për t'u garantuar. Në këto raste, është e rëndësishme së pari të pranohet rreziku, e më pas të garantohet një qasje proporcionale për të ndërtuar gatishmërinë e

përgjithshme për të trajtuar dhe zvogëluar pasojat. "Fokusi duhet të jetë në testimin e kapacitetit për t'iu përgjigjur emergjencave dytësore që shkaktohen nga dëmtimi i infrastrukturës kritike."[88]

